



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA RREGULLATORE PËR UJËSJELLËS DHE KANALIZIM
REGULATORNI URED ZA VODU I KANALIZACIJU
WATER AND WASTEWATER REGULATORY OFFICE



TARIFAT PËR SHËRBIMET E FURNIZIMIT ME UJË DHE SHËRBIME TË UJËRAVE TË ZEZA 2015-2017

Raport i të dhënave të rishikimit të procesit tarifor për përcaktim të tarifave për periudhën
tarifore 2015-2017 për shtatë kompanitë rajonale të licencuara për ofrimin e shërbimeve
publike të furnizimit me ujë dhe shërbime të ujërave të zeza

Prishtinë, Mars 2015

Përgatitur dhe Publikuar nga: Departamenti për Financa dhe Tarifa Rregullatore, ZRRUK

Prishtinë, Mars 2015

Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim

Vizioni

“Shërbime cilësore, të sigurta dhe efçente të ujësjellësit dhe ujërave të zeza për të gjithë konsumatorët në tërë Kosovën.”

Misioni

“Rregullimi i shërbimeve të ujit dhe ujërave të zeza në mënyrë efektive dhe transparente në pajtim me praktikën e mira Evropiane të cilat sigurojnë që ofruesit e shërbimeve të ujësjellësit dhe të kanalizimit ofrojnë shërbime kualitative, të qëndrueshme dhe me çmime të përballueshme në tërë Kosovën, duke pasur parasysh ruajtjen e mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit publik.”

TARIFAT PËR SHËRBIMET E FURNIZIMIT ME UJË DHE SHËRBIMET PËR UJËRA TË ZEZA

2015 - 2017

PËRMBAJTJA

Fjala hyrëse.....	v
Roli dhe përgjegjësitë e ZRRUK	vii
Rezultatet kryesore.....	viii
obligimet KONTRaktuese TË KRU-ve.....	ix
<i>Kompania Rajonale e Ujit 'Prishtina' (Prishtinë)</i>	ix
<i>Detaje të investimeve kapitale për ujë nga kredite në KRU 'Prishtina'</i>	x
<i>Kompania Rajonale e Ujit Hidroregjioni Jugor (Prizren)</i>	xi
<i>Kompania Rajonale e Ujit Hidrodrini (Pejë)</i>	xii
<i>Kompania Rajonale e Ujit Mitrovica (Mitrovicë)</i>	xiii
<i>Kompania Rajonale e Ujit Radoniqi (Gjakovë)</i>	xiv
<i>Kompania Rajonale e Ujit Bifurkacioni (Ferizaj)</i>	xv
<i>Kompania Rajonale e Ujit Hidromorava (Gjilan)</i>	xvi
1 Qasja e ZRRUK në përcaktimin e tarifave	1
1.1 Historiku.....	1
1.2 Procesi i përcaktimit të tarifave	1
1.2.1 Politikat tarifore	2
1.2.2 Biznes planet dhe aplikacionet tarifore të kompanive	3
1.2.3 Shqyrtimi i aplikacioneve të KRU nga ZRRUK	3
1.2.4 Draft tarifat dhe konsultimi	4
1.2.5 Tarifat e finalizuar	5
2 Aktet dhe konceptet rregullatore	6
2.1 Udhëzimet e kontabilitetit rregullator (UKRr)	6
2.2 Tarifat dhe vlerësimi i niveleve të shërbimeve	7
2.3 Krahasimi (Benchmarking).....	7
3 Shqyrtimi i aplikacioneve të KRU	9
3.1 Përbërja e tarifës	9
3.2 Shpenzimet operative.....	10
3.3 Subvencionimet operative / subvencionimet e Qeverisë.....	11
3.4 Eficienca komerciale	11
3.5 Shpenzimet kapitale	11
3.6 Baza rregullatore e aseteve dhe kthimi në kapital	12
3.6.1 Baza rregullatore e aseteve	12
3.6.2 Kthimi në kapital.....	13
3.7 Konsumatori dhe ritja e shitjeve	13
3.7.1 Mbulueshmëria me shërbime	13
3.7.2 Projektionet e shitjeve (volumetrike dhe në vlerë monetare)	15
3.8 Strukturat e tarifës.....	16
3.8.1 Ngarkesat fikse dhe ato të ndryshueshme	16
3.8.2 Ndër-subvencionimi nga konsumatorët jo-shtëpiak në konsumatorët shtëpiak	16
4 Tarifat dhe ndikimi në faturat për konsumatorët shtëpiak	17
4.1 Tarifat për vitet 2012 – 2014	17
4.2 Ndikimi në faturat e konsumatorëve shtëpiak	17
ANNEX 1 Kërkesa për të ardhura	19
ANNEX 2 Shpenzimet operative.....	20
ANNEX 3 Eficienca komerciale	24
ANNEX 4 Programi i shpenzimeve kapitale	26
ANNEX 5 Projektionet për konsumatorë.....	30
ANNEX 6 Tarifat e 2015 – 2017	31

Akronimet dhe shkurtesat

AMMK	Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
BRrA	Baza Rregullatore e Aseteve
FE	Kompania Rajonale e Ujësjetllësit Bifurkacioni (Ferizaj)
GJA	Kompania Rajonale e Ujësjetllësit Radoniqi (Gjakova)
GJI	Kompania Rajonale e Ujësjetllësit Hidromorava (Gjilan)
IKSHPK	Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës
KKK	Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve
KRU	Kompania Rajonale e Ujit
MÇAK(CAPM)	Modeli i Çmimit të Aseteve Kapitale
MIT	Kompania Rajonale e Ujit Mitrovica (Mitrovicë)
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
NP	Ndërmarrjet Publike
NjPMNP	Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike
PE	Kompania Rajonale e Ujësjetllësit Hidrodrini (Pejë)
PR	Kompania Rajonale e Ujësjetllësit Prishtina (Prishtinë)
PZ	Kompania Rajonale e Ujësjetllësit Hidroregjioni Jugor (Prizren)
ZNKE	Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian
ZRRUK	Zyra Rregullatore për Ujësjetllës dhe Kanalizim
DFTRR	Departamenti për Finnaca dhe Tarifa Rregullatore

FJALA HYRËSE



Është procesi i pestë rregullatorë i përcaktimit të tarifave të shërbimeve publike të furnizimit me ujë me pakicë dhe shumicë si dhe për shërbimet e ofruara për trajtim dhe grumbullim të ujërave të zeza. Gjatë proceseve të gjertanishme tarifore kemi përcaktuar tarifa të rregullta rregullatore gjatë 2 procese tarifore një vjeçare dhe 3 proceseve rregullatore të tarifave 3 vjeçare.

Gjatë periudhës së kaluar 10 vjeçare të ekzistimit të Zyrës Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizime në Kosovë kemi kaluar një përvojë të caktuar në rregullimin e shërbimeve publike të ujit dhe grumbullimit të ujërave të zeza, në kuadër të cilave zë vend me rëndësi edhe procesi rregullator i përcaktimit të tarifave të shërbimeve publike të ujit. Periudha e kaluar ka qenë me sfida të theksuara të cilat jemi mundua me i zgjedh në mënyrën më të mirë dhe më të lehtë të mundshme në interes të ndërlidhura të këtij sektori.

Sipas mandatit tonë ligjorë të dhënë dhe eksperiencës sonë, kemi kënaqësinë tonë që na u dha mundësia e përcaktimit të tarifave të radhës për shërbimin publik të ujit, të periudhës afatmesme 3 vjeçare 2015-2017, të cilat do të zbatohen nga secila prej shtatë Kompanive Rajonale të Ujësjellësit (KRU) në Kosovë dhe të një kompanie për furnizim të ujit me shumicë të pa trajtuar për tre vitet e ardhshme, duke filluar nga 1 Janari 2015 dhe pas rishikimeve eventuale të ndërmjetme të tarifave fillestare të periudhës aktuale të njëjtat do të jenë obligative për t'u aplikuar edhe gjatë viteve 2016 dhe 2017.

Ky dokument pasqyron dhe shpjegon procesin dhe bazat mbi të cilat ZRRUK ka marr vendim për përcaktim të tarifave të shërbimit të ujit dhe përcakton supozimet e pritshme për vendimmarrjen tonë.

Detyra themelore e rregullatorit ka qenë dhe është balancimi i interesave të konsumatorëve për marrjen e shërbimeve të ujit, me nevojën për të ruajtur integritetin financiar të KRU-ve. Ne kemi detyrë të sigurojmë që KRU të operojnë në mënyrën më efikase të mundshme, për tu siguruar që konsumatorët të paguajnë jo më shumë se sa është e nevojshme. Gjatë përcaktimit të këtyre tarifave, ne gjithashtu kemi marrë parasysh aftësinë e konsumatorëve për të paguar faturat e tyre.

Tarifat e reja sektoriale parashikojnë rritje reale të faturave të konsumatorëve shtëpiak për furnizim me ujë dhe shërbime të ujërave të zeza gjatë vitit 2015 dhe 2016 për 1.74% në krahasim me tarifën e vitit të përmbysur tariforë 2014. Ndërsa tarifën e vitit 2017 me proces tariforë të udhëhequr gjatë gjysmës së dytë të vitit 2014 është planifikuar të kenë një ngritje për vetëm 0.34%. Tarifën e konsumatorëve jo-shtëpiakë në përputhje me politikat rregullatore do të kenë ulje nga viti 2015 gjer në fund të vitit 2017 për 3.73% në krahasim me tarifën e aplikuar gjatë vitit 2014.

Faturat mesatare për konsumatorët shtëpiak për konsumin mesatar të ujit të matur prej 16.30 m³/muaj të regjistruar, muaj pas muaji, dhe të pasqyruara në Biznes Planet Rregullatore të KRU-ve gjatë vitit 2014 kanë arrit vlerën mujore prej 8.89 €/muaj dhe për sasinë mujore të ujit të planifikuar për t'u furnizuar prej 17.48 m³/muaj për të njëjtën kategori të konsumatorëve sipas BPRR-ve të aprovuara gjatë vitit 2015 shuma e faturës do të arrijë 9.66 €/muaj dhe për sasinë e ujit të planifikuar për të furnizuar gjatë vitit 2017 prej 18.04m³/muaj fatura mujore do të arrij vlerën prej 10.02 €/muaj. Ndërsa proporcioni i shumës së faturave për konsumatorët jo-shtëpiakë ka tendencë ulje me raportin ekzistues gjatë procesit rregullatorë të tarifave 2012-2014 i mbështetur në Politikat tona tarifore.

ZRRUK beson se konsumatorët shtëpiakë do të jenë në gjendje të përballojnë ngritjen simbolike të tarifave të shërbimeve publike të ujit. Gjatë viteve të fundit, konsumatorët po i kushtojnë në vazhdimësi kujdes më të madh këtij shërbimi jetik dhe për çdo ditë për të njëjtin numër i theksuar i tyre po komunikojnë me kompaninë dhe ZRRUK-un për të marr shërbime të mira për koston që po e paguajnë për to. Ne jemi të sigurt se konsumatorët do të jenë të gatshëm të paguajnë më shumë për tu siguruar shërbimi i ujit dhe ujërave të zeza që ata marrin. Si pjesë e procesit të përcaktimit të këtyre tarifave,

ZRRUK është konsultuar me Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve, të cilët përfaqësojnë interesat e konsumatorëve në çdo regjion veç e veç.

Konsumatori po ndërgjegjësohet se shërbimet e ujit duhet paguar dhe se në të njëjtën kohë duhet ruajtur dhe kursyer ujin për mos ta përdorë për qëllime të tjera sekondare. ZRRUK punon në vazhdimësi për të aplikuar politika të drejta për ta mbështet kompaninë, por në të njëjtën kohë edhe për ta mbrojt atë (konsumatorin) nga shërbimet eventuale jo adekuate. Sa i përket rasteve të konsumatorëve që kanë vërtetë vështirësi për të paguar, ata duhet të ndihmohen nga institucionet përkatëse, por ne duhet të zhdukim dukurinë *“nuk dua që të paguaj”*, mentalitet i cili është shumë i përhapur në mesin e atyre që mund të përballojnë që të paguajnë faturat e tyre e nuk e bëjnë një gjë të tillë.

Nga karakteristikat dalluese të procesit të kaluar rregullatorë të periudhës 2012-2014 duhet theksuar faktin se kemi përmirësime të pakta të efijencies vit pas viti në krahasim me vitin paraprak, sikurse duhet theksuar faktin se vështirësi të theksuar gjatë vitit 2013 dhe gjysmë vjetorit të parë të vitit 2014 kanë qenë të reshurat e pakta atmosferike në regjionin Prishtinës dhe Gjilanit, të karakterizuar me thatësi të gjatë kohore të pa regjistruar si të tilla me dekada, gjatë të cilës periudhë kemi identifikuar faktin se kompanitë nuk kanë pas plane adekuate për përballim eventual të tyre në periudha të gjata kohore.

ZRRUK, është i brengosur se shumica e kompanive nuk po i realizojnë investimet e planifikuara dhe nuk po planifikojnë mjaftueshëm projekte të cilat duhet të financohen nga mjetet vetanake financiare. Në këtë mënyrë vlera e aseteve vetanake po ulët vit pas viti, gjë që nuk është mirë as për kompaninë e as shoqërinë.

Shumica e KRU-ve po e kuptojnë faktin se vetëm Biznes Planet Rregullatore janë plane të bazuara nga të cilat dalin edhe *“obligimet kontraktuese” pasi ato i përcaktojnë tarifat e shërbimeve dhe të vetmet ato janë tregues i efijencies të arritura dhe të pritshme të shërbimeve publike të ujit*. Ne do të jemi këmbëngulës në vendosmërinë tonë për të siguruar që KRU-të të përmbushin detyrimet e tyre të kontraktuara. Ne në mënyrë rigorozë do të monitorojmë performancën kundrejt detyrimeve të tilla dhe ne nuk do të ngurrojmë që publikisht t'i tërheqim vërejtjen KRU-ve që nuk përmbushin detyrimet e tyre. Për nivelin e përmbushjes së objektivave – në vazhdimësi do të njoftohet NJPMNP, MZHE e Qeverisë së Republikës së Kosovës bashku me rekomandimet për veprimet e mëtejme që duhet ndërmarrë.

Do të doja të falënderoj KRU-të për bashkëpunimin e tyre në përgatitjen e Biznes Planeve Rregullatore. Procesi i përcaktimit të tarifave ka avancuar, por pritjet tona janë edhe ma të mëdha, shpresoj se ne do të vazhdojmë të punojmë së bashku në interes të konsumatorëve e për të siguruar se sektori i ujit dhe ujërave të zeza në Kosovë mund të fillojë të krahasohet me shërbimet që ofrohen në vendet Evropiane.

Tarifat në Kosovë janë ende shumë më të vogla se ato në vendet tjera Evropiane e në shumë raste edhe se ato të regjionit, ku te disa nga to edhe nivelet e shërbimit janë shumë më të larta. Në planin afatgjatë tarifat do të duhet të rriten ndjeshëm më shumë se rritjet e përcaktuara në këtë raport. Kjo veçanërisht vlen për ujërat e zeza ku investimet janë mase të domosdoshme dhe të konsiderueshme për përmbushjen e kërkesave mjedisore të BE-së.

Në fund dëshirojë të falënderojë personelin e ZRRUK-ut, kompanitë dhe te të gjithë ata që në çfarëdo forme kanë kontribuar në përmbylljen e këtij procesi rregullatorë të tarifave, të cilin e konsideroj të suksesshme me përcaktimin e tarifave të këtij 3 vjeçari, pa e anashkaluar edhe konsultat që kemi pas edhe me Këshillat Konsultative të konsumatorëve në të gjitha regjionet e selive të KRU-ve.

Raif Preteni

Drejtor i ZRRUK

Mars 2015

ROLI DHE PËRGJEGJËSITË E ZRRUK

Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim (ZRRUK) është themeluar në vitin 2004 përmes Rregullorës së UNMIK 2004/49 e cila më pas është zëvendësuar me Ligjin Nr. 03/L-086 i miratuar nga Kuvendi i Kosovës në Qershor 2008. Në pajtueshmëri me këtë Ligj, ne raportojmë aktivitetet tona dhe jemi llogaridhënës para Kuvendit të Kosovës.

Roli jonë si rregullator ekonomik për sektorët e furnizimit me ujë dhe shërbimeve të ujërave të zeza është për të siguruar se ofruesit e rregulluar të shërbimeve (ofruesit e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe shërbimeve të ujërave të zeza të cilët janë në pronësi publike dhe shoqërore), nuk keqpërdorin pozitën e tyre monopoliste duke u siguruar që ato të ofrojnë një standard të arsyeshëm të shërbimit me një tarifë të arsyeshme dhe se të drejtat dhe detyrimet e tyre, dhe ato të konsumatorëve të tyre, janë të balancuara në mënyrë të drejtë dhe që të njëjtat zbatohen. Për të arritur këtë rol, ne ndërmarrim këto aktivitete kryesore:

- Përcaktimin e tarifave në nivele të mjaftueshme për ofruesit e shërbimeve për të financuar aktivitetet e tyre në përputhje me standardet e obligueshme të shërbimit dhe në nivel të pranueshëm të pritjeve për shërbime, por në të njëjtën kohë duke promovuar efikasitetin për të siguruar që tarifat nuk janë më të larta se sa ato që do duhej të ishin;
- Duke siguruar që ofruesit e shërbimeve përmbushin obligimet e tyre në lidhje me nivelin e shërbimeve;
- Licensimin e ofruesve të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe shërbimeve të ujërave të zeza;
- Stimulimin e konkurrencës përmes krahasimit (benchmarking) si dhe raportimit të rregullt të performancës në baza periodike dhe atë vjetore;
- Mbrojtjen e interesave të konsumatorëve duke siguruar që ofruesit e licensuar të shërbimeve nuk keqpërdorin pozitën e tyre monopoliste dhe duke siguruar që shërbimet e ofruara të jenë në përputhje me standardet e vendosura;
- Krijimin dhe mbështetjen e Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve;
- Sigurimin e një mekanizmi për konsumatorët që të parashtrojnë ankesa ndaj ofruesve të shërbimeve përmes Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve (KKK) dhe në fund edhe drejtëpërdrejtë në ZRRUK.

Në pajtim me praktikën e mirë rregullatore, qasja jonë është e orientuar drejt rezultateve konkrete. Kryesisht interesohemi në lidhje me nivelet e shërbimit dhe shpenzimet e përgjithshme. Pra, ne nuk ndërhyjmë drejtëpërdrejtë në menaxhimin ditor të ofruesve të licensuar të shërbimeve, duke e lënë këtë përgjegjësi për menaxhmentet si dhe bordet e ofruesve të shërbimit. Për më tepër, nuk kemi asnjë juridiksion mbi furnizimet private me ujë, prodhuesve të ujit në shishe ose operatorëve që nuk janë në pronësi publike e që ofrojnë shërbimet e tyre jashtë zonave të definuara të furnizimit të NP, p.sh. furnizimi me ujë në zonat rurale.

Ne nuk jemi përgjegjës për vendosjen e standardeve të cilësisë së ujit të pijshëm ose për monitorimin e cilësisë së ujit të pijshëm. Kjo është përgjegjësi e Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik (IKSHP). Megjithatë ne punojmë për së afërmi me IKSHP, veçanërisht në shkëmbimin e të dhënave që kanë të bëjnë me respektimin e niveleve të përcaktuara për cilësinë e ujit dhe për këtë kemi një Marrëveshje Mirëkuptimi.

Në mënyrë të ngjashme, ne nuk jemi përgjegjës për mbrojtjen e mjedisit. Kjo është përgjegjësi e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) dhe Agjencisë Kosovare për Mbrojtjen e Mjedisit (AKMM). Megjithatë, qasja jonë është për të siguruar që politikat dhe procedurat tona nuk dëmtojnë mjedisin dhe shëndetin publik dhe ku është e mundur ne bashkëpunojm ngushtë me rregullatorët tjerë.

REZULTATET KRYESORE

Shënim: rezultatet e paraqitura në vijim i referohen mesatareve të sektorit. Ngarkesat për faturat mujore për konsumatorët individual ndryshojnë varësisht se nga cila KRU shërbehet ai konsumatorë si dhe nga volumi i ujit të konsumuar. Për më tepër, caqet e performancës për KRU e veçanta poashtu ndryshojnë nga njëra tjetra.

Tarifat dhe ngarkesat për konsumatorët shtëpiak

- Deri në fund të vitit 2017 tarifa fikse për ujë do të ngelet e pandryshuar në nivelin e tanishëm prej 1.00 € për konsumatorë shtëpiak për muaj dhe 3.00 € për konsumatorët komercial dhe institucional.
- Tarifat volumetrike për ujë kanë pasur ngritje të lehtë të shumica e KRU-ve, përpos që kanë mbetur tarifat e pa ndryshuara për këtë kategori tek KRU “Hidroregjioni Jugor”, “Radoniqi” dhe “Hidromorava”.
- Tarifat volumetrike për ujëra të zeza, si mesatare e sektorit, kane mbetur të njëjta me ato të vitit 2014. Tek disa kompani ka pasur ulje të tyre, kurse tek disa të tjera ka pasur ngritje, kjo si pasojë e të dhënave të planifikuara nga KRU.
- Të gjitha këto lëvizje të tarifave kanë qenë të domosdoshme për t’u përshtatur gjendjes ekonomike që po mbizotëron në Kosovë si dhe nevojës për të realizuar investimet kapitale.
- Tarifat janë dizajnuar për të siguruar që mos të ketë ndër-subvencionim në mes të tarifave të ujit dhe ujërave të zeza.
- Sa i përket tarifave të furnizimit me ujë ka një zvogëlim të vogël të ndër-subvencionimit nga konsumatorët jo-shtëpiak në ata shtëpiak.

Pritjet e përmirësimit të efijencës

- ZRRUK ka ndërmarrë masa të nevojshme për të reduktuar shuma të konsiderueshme të shpenzimeve opartive, duke i përafruar ato me mesataren e sektorit.
- KRU-të pritet që deri në vitin 2017 të rrisin shkallën e arkëtimit nga 62% në 73% (konsumatorët shtëpiak), 80% në 93% (konsumatorët komercial) dhe 93% në 98% (konsumatorët institucional).

Investimet kapitale

- Nga KRU pritet që të zbatojnë programin e investimeve për furnizim me ujë 11.6 milion € prej burimeve vetanake, 83.3 milion të financuara nga grantet, dhe investime prej kredive në vlerë prej 11.6 milion € përgjatë periudhës 2015 – 2017.
- Nga KRU pritet që të zbatojnë programin e investimeve për shërbimet për ujëra të zeza në vlerë prej 42.6 milion € (2.9 milion € nga resurset vetanake dhe EURO 39.6 milion të financuara nga grantet) përgjatë periudhës 2015 – 2017.

Rritja e numrit të konsumatorëve dhe nivelet e shërbimit

- KRU pritet që të rrisin numrin e konsumatorëve të shërbimeve të furnizimit me ujë për më shumë se 12,000 në vit, pra duke e rritur numrin e konsumatorëve nga 278,211 që është në vitin 2014 në 314,963 konsumatorë në vitin 2017. Kjo rezulton me rritje të mbulueshmërisë së shërbimeve të furnizimit me ujë nga 82% në 2014 në 87% në 2017.
- Poashtu pritet që numri i konsumatorëve të shërbimeve për ujëra të zeza të rritet mesatarisht për 6,500 në vit, pra do të rritet nga 209,639 që është numër i konsumatorëve në 2014 në 229,300 në 2017. Kjo ngritje do të rezultojë që mbulueshmëria me shërbime të rritet nga 60% në 2014 në 62% në 2017.

OBLIGIMET KONTRAKTUESE TË KRU-ve

Biznes planet finale të dakorduara përbëjnë kontrata të nënkuptuara të detyrimeve në bazë të të cilave rregullatori pajtohet me ato tarifa që bazohen në detyrimin e marrë nga KRU për të dhënë rezultatet e përcaktuara në biznes planet e tyre. Dështimi për të arritur një objektiv do të ketë pasoja serioze në objektivat e tjera, p.sh. dështimi për të arritur shkallën e arkëtimit do të rezultojë në të ardhura më të ulëta se ato që ishin planifikuar dhe në këtë mënyrë pengojnë aftësinë e KRU për të përmbushur detyrimet e tyre në lidhje me investimet. Edhe pse objektivat janë sfiduese, ne besojmë se ato janë të arritshme, por për sukses të vërtetë KRU duhet të përpiqen për të përmbushur apo edhe tejkalojnë të gjitha objektivat, dhe jo vetëm disa prej tyre.

Ne kemi identifikuar të dhënat kyçe për arritjen e suksesshme të shqyrtimit të tarifave dhe të njëjtat i kemi paraqitur në formë tabelare për secilën KRU si “Obligimet Kontraktuese”.

Kompania Rajonale e Ujësjesit ‘Prishtina’ (Prishtinë)

Obligimet e KRU					
Efiçienca e shpenzimeve operative					
Shërbimet e furnizimit me ujë	Reduktim i shpenzimeve operative totale për tre vite të procesit tarifar 2015-2017, prej 29,657,713 € në 27,091,907 € pra një zvogëlim prej 2,583,805 € (në nivelet e çmimeve të 2014). Këto reduktime janë bazuar duke përfshirë shpenzimet operative me mesataren e sektorit si dhe duke u bazuar në shpenzimet për zërat e njëjtë të vitit 2014.				
Shërbimet për ujëra të zeza	Shpenzimet operative për ujëra të zeza, Rregullatori nuk ka sfiduar dhe ato kanë vlerën prej 1,651,007 €, për tre vitet e procesit rregullator 2015-2017.				
Efiçienca (arkëtimi i të ardhurave) komerciale		Kons.shtëpiak	Kons.komercial	Kons.institucion	
	2014 (aktuale)	64%	82%	92%	
	2017 (minimum)	77%	93%	97%	
Investimet kapitale 2015 – 2017 (EURO x 1000 në nivelet e çmimeve të 2014)		Resurset e KRU-së	Kredi	Grante	Totali
Furnizimi me ujë	Përtëritjet infrastrukturore	1,960	3,967	7,367	13,293
	Rritja infrastrukturore	50	0	0	50
	Mirëmbajtja kapitale për jo-infrastrukturë	508	0	1,000	1,508
	Rritja jo-infrastrukturë	1,545	7,595	15,000	24,140
	Aktivitetet Biznesore	2,206	0	0	2,206
	Totali	6,269	11,562	23,367	41,197
Shërbimet për ujërat e zeza	Përtëritjet infrastrukturore	675	0	0	675
	Rritja infrastrukturore	0	0	0	0
	Mirëmbajtja kapitale për jo-infrastrukturë	0	0	0	0
	Rritja jo-infrastrukturë	0	0	0	0
	Aktivitetet Biznesore	218	0	0	218
	Totali	893	0	0	893
Konsumatorët & shitjet					
Furnizimi me ujë	Numri i konsumatorëve shtëpiak të ngriten nga 90,918 në 2014 në 103,802 deri në fund të 2017				
Ujërat e zeza	Numri i konsumatorëve shtëpiak të rritet nga 74,167 në 2014 në 84,743 deri në fund të 2017				
Shitjet për ujë	Të rritet nga 22.4 milion m ³ në vit në 2014 në 29.8 milion m ³ në vit deri në 2017				
Qarkullimi i shitjeve për ujë dhe ujëra të zeza (duke përfshirë taksat e kyçjes dhe të ardhurat tjera)	Të rritet nga 13.5 milion € në 2014 në 18.1 milion € deri në 2017 (në nivelet e çmimeve të 2014)				

Detaje të investimeve kapitale për ujë nga kredite në KRU 'Prishtina'

(EURO x 1000 ne nivelet e çmimeve të 2014)

Financimet e projekteve të investimeve kapitale 2015-2017 (pa rishikim të tarifave 2016-2017)		Financimet nga kreditë, grantet dhe donatorët			
Vetanake	Kthimi i kredisë	Financimet nga kredia e KRU-së	Grante nga qeveria vendore	Grante nga Komuna	Grante nga donatorët e jashtëm
a	b	c	d	e	f
6,269	7,023	11,562	0	5,000	18,366
a+b= 13,292		c+d+e+f=34,928			

Shënim: Të dhënat e pasqyruara në këtë pasqyrë janë të definuara për obligimet e kompanisë për realizim të projekteve kapitale të financuar nga vet kompania dhe obligimet e kthimit të kredisë për vitin 2015, ndërsa të dhënat e viteve 2016 dhe 2017 nuk janë të pasqyruara saktë pasi, akoma nuk kemi gjetë gadishmëri nga (gjerë në këtë moment kur po e mbyllim këtë raport) përfaqesuesit e kompanisë për t'i definuar saktë projektet e investimeve kapitale të financuara nga vet kompania, obligimet kreditore të arritura për kthim, shumat e kredisë së shfrytëzuar për projekte investive në vijimë për këto dy vite dhe shumat e planifikuara nga donatorët për të investuar në projekte të përbashkëta dhe të veqanta. Kjo çështje pritet të zgjidhet gjatë javëve, ose mujave ne vijim.

Kompania Rajonale e Ujësjetësit Hidroregjioni Jugor (Prizren)

Obligimet e KRU				
Efiçienca e shpenzimeve operative				
Shërbimet e furnizimit me ujë	Reduktim i shpenzimeve operative totale për tre vite të procesit tarifar 2015-2017, prej 9,730,473 € në 9,209,496 € pra një zvogëlim prej 520,977 € (në nivelet e çmimeve të 2014). Këto reduktime janë bazuar duke përfshirë shpenzimet operative me mesataren e sektorit si dhe duke u bazuar në shpenzimet për zërat e njëjtë të vitit 2014.			
Shërbimet për ujëra të zeza	Reduktim i shpenzimeve operative totale për tre vite të procesit tarifar 2015-2017, prej 999,776 € në 712,529 € pra një zvogëlim prej 287,247 € (në nivelet e çmimeve të 2014). Këto reduktime janë bazuar duke u bazuar në shpenzimet për zërat e njëjtë të vitit 2014.			
Efiçienca (arkëtimi i të ardhurave) komerciale		Kons.shtëpiak	Kons.komercial	Kons.institucion
	2014 (aktuale)	69%	89%	95%
	2017 (minimum)	76%	91%	98%
Investimet kapitale 2015 – 2017 (EURO x 1000 në nivelet e çmimeve të 2014)		Resurset e KRU-së	Grante	Totali
Furnizimi me ujë	Përtëritjet infrastrukturore	338	15,972	16,310
	Rritja infrastrukturore	311	6,975	7,286
	Mirëmbajtja kapitale për jo-infrastrukturë	175	120	295
	Rritja jo-infrastrukturë	30	16,590	16,620
	Aktivitetet Biznesore	48	100	148
	Totali	902	39,757	40,659
Shërbimet për ujërat e zeza	Përtëritjet infrastrukturore	240	2,050	2,290
	Rritja infrastrukturore	0	6,104	6,104
	Mirëmbajtja kapitale për jo-infrastrukturë	3	1,650	1,653
	Rritja jo-infrastrukturë	0	8,548	8,548
	Aktivitetet Biznesore	0	1,550	1,550
	Totali	243	19,902	20,145
Konsumatorët & shitjet				
Furnizimi me ujë	Numri i konsumatorëve shtëpiak të ngriten nga 34,793 në 2014 në 42,649 deri në fund të 2017			
Ujërat e zeza	Numri i konsumatorëve shtëpiak të rritet nga 29,178 në 2014 në 31,149 deri në fund të 2017			
Shitjet për ujë	Të rritet nga 8.3 milion m ³ në vit në 2014 në 9.9 milion m ³ në vit deri në 2017			
Qarkullimi i shitjeve për ujë dhe ujëra të zeza (duke përfshirë taksat e kycjes dhe të ardhurat tjera)	Të rritet nga 4.5 milion € në 2014 në 5.3 milion € deri në 2017 (në nivelet e çmimeve të 2014)			

Kompania Rajonale e Ujësjiellësit Hidrodrini (Pejë)

Obligimet e KRU				
Efiçienca e shpenzimeve operative				
Shërbimet e furnizimit me ujë	Reduktim i shpenzimeve operative totale për tre vite të procesit tarifar 2015-2017, prej 6,754,394 € në 6,130,252 € pra një zvogëlim prej 624,142 € (në nivelet e çmimeve të 2014). Këto reduktime janë bazuar duke përafëruar shpenzimet operative me mesataren e sektorit si dhe duke u bazuar në shpenzimet për zërat e njëjtë të vitit 2014.			
Shërbimet për ujëra të zeza	Shpenzimet operative për ujëra të zeza, Rregullatori nuk ka sfiduar dhe ato kanë vlerën prej 405,649 €, për tre vitet e procesit rregullator 2015-2017.			
Efiçienca (arkëtimi i të ardhurave) komerciale		Kons.shtëpiak	Kons.komercial	Kons.institucion
	2014 (aktuale)	60%	75%	95%
	2017 (minimum)	75%	90%	98%
Investimet kapitale 2015 – 2017 (EURO x 1000 në nivelet e çmimeve të 2014)		Resurset e KRU-së	Grante	Totali
Furnizimi me ujë	Përtëritjet infrastrukturore	420	0	420
	Rritja infrastrukturore	210	400	610
	Mirëmbajtja kapitale për jo-infrastrukturë	175	0	175
	Rritja jo-infrastrukturore	440	16	456
	Aktivitetet Biznesore	400	90	490
	Totali	1,645	506	2,151
Shërbimet për ujërat e zeza	Përtëritjet infrastrukturore	180	0	180
	Rritja infrastrukturore	100	816	916
	Mirëmbajtja kapitale për jo-infrastrukturë	15	0	15
	Rritja jo-infrastrukturore	0	0	0
	Aktivitetet Biznesore	319	0	319
	Totali	614	816	1,430
Konsumatorët & shitjet				
Furnizimi me ujë	Numri i konsumatorëve shtëpiak të ngriten nga 34,123 në 2014 në 37,850 deri në fund të 2017			
Ujërat e zeza	Numri i konsumatorëve shtëpiak të rritet nga 14,041 në 2014 në 14,125 deri në fund të 2017			
Shitjet për ujë	Të rritet nga 9.3 milion m ³ në vit në 2014 në 10.3 milion m ³ në vit deri në 2017			
Qarkullimi i shitjeve për ujë dhe ujëra të zeza (duke përjashtuar taksat e kyçjes dhe të ardhurat tjera)	Të rritet nga 3.4 milion € në 2014 në 3.8 milion € deri në 2017 (në nivelet e çmimeve të 2014)			

Kompania Rajonale e Ujësjetllësit Mitrovica (Mitrovicë)

Obligimet e KRU				
Eficienca e shpenzimeve operative				
Shërbimet e furnizimit me ujë	Shpenzimet operative për shërbimet e ujit, Rregullatori nuk i ka sfiduar dhe ato kanë vlerën prej 6,444,867 €, për tre vitet e procesit rregullator 2015-2017.			
Shërbimet për ujëra të zeza	Në të njëjtën mënyrë është vepruar edhe për shpenzimet e ujërave të zeza, ato nuk kanë ndryshuar dhe kanë vlerën prej 592,106 €, për tre vitet e procesit rregullator 2015-2017.			
Eficienca (arkëtimi i të ardhurave) komerciale		Kons.shtëpiak	Kons.komercial	Kons.institucion
	2014 (aktuale)	42%	85%	100%
	2017 (minimum)	64%	97%	100%
Investimet kapitale 2015 – 2017 (EURO x 1000 ne nivelet e çmimeve të 2014)		Resurset e KRU-së	Grante	Totali
Furnizimi me ujë	Përtëritjet infrastrukturore	0	1,500	1,500
	Rritja infrastrukturore	0	2,111	2,111
	Mirëmbajtja kapitale për jo-infrastrukturë	0	0	0
	Rritja jo-infrastrukturore	0	1,955	1,955
	Aktivitete Biznesore	0	256	256
	Totali	0	5,822	5,822
Shërbimet për ujërat e zeza	Përtëritjet infrastrukturore	200	0	200
	Rritja infrastrukturore	0	0	0
	Mirëmbajtja kapitale për jo-infrastrukturë	0	0	0
	Rritja jo-infrastrukturore	0	0	0
	Aktivitete Biznesore	0	0	0
	Totali	200	0	200
Konsumatorët & shitjet				
Furnizimi me ujë	Numri i konsumatorëve shtëpiak të ngriten nga 21,956 në 2014 në 27,046 deri në fund të 2017			
Ujërat e zeza	Numri i konsumatorëve shtëpiak të rritet nga 16,827 në 2014 në 18,577 deri në fund të 2017			
Shitjet për ujë pa veriun e qytetit të Mitrovicës	Të rritet nga 4.3 milion m ³ në vit në 2014 në 6.9 milion m ³ në vit deri në 2017			
Qarkullimi i shitjeve për ujë dhe ujëra të zeza (duke përfshirë taksat e kycjes dhe të ardhurat tjera)	Të rritet nga 2.48 milion € në 2014 në 3.62 milion € deri në 2017 (në nivelet e çmimeve të 2014)			

Kompania Rajonale e Ujësjetillësit Radoniqi (Gjakovë)

Obligimet e KRU				
Eficienca e shpenzimeve operative				
Shërbimet e furnizimit me ujë	Reduktim i shpenzimeve operative totale për tre vite të procesit tarifar 2015-2017, prej 7,219,780 € në 6,462,882 € pra një zvogëlim prej 756,897 € (në nivelet e çmimeve të 2014). Këto reduktime janë bazuar duke përfshirë shpenzimet operative me mesataren e sektorit.			
Shërbimet për ujëra të zeza	Shpenzimet operative për ujëra të zeza, Rregullatori nuk i ka sfiduar dhe ato kanë vlerën prej 782,648 €, për tre vitet e procesit rregullator 2015-2017.			
Eficienca (arkëtimi i të ardhurave) komerciale		Kons.shtëpiak	Kons.komercial	Kons.institucion
	2014 (aktuale)	69%	77%	96%
	2017 (minimum)	75%	94%	98%
Investimet kapitale 2015 – 2017 (EURO x 1000 në nivelet e çmimeve të 2014)		Resurset e KRU-së	Grante	Totali
Furnizimi me ujë	Përtëritjet infrastrukturore	360	1,950	2,310
	Rritja infrastrukturore	900	4,650	5,550
	Mirëmbajtja kapitale për jo-infrastrukturë	0	0	0
	Rritja jo-infrastrukturë	0	0	0
	Aktivitetet Biznesore	194	0	194
	Totali	1,454	6,600	8,054
Shërbimet për ujërat e zeza	Përtëritjet infrastrukturore	75	0	75
	Rritja infrastrukturore	0	14,000	14,000
	Mirëmbajtja kapitale për jo-infrastrukturë	0	0	0
	Rritja jo-infrastrukturë	0	0	0
	Aktivitetet Biznesore	0	0	0
	Totali	75	14,000	14,075
Konsumatorët & shitjet				
Furnizimi me ujë	Numri i konsumatorëve shtëpiak të ngriten nga 26,480 në 2014 në 27,252 deri në fund të 2017			
Ujërat e zeza	Numri i konsumatorëve shtëpiak të rritet nga 14,205 në 2014 në 15,502 deri në fund të 2017			
Shitjet për ujë	Të rritet nga 7.39 milion m ³ në vit në 2014 në 7.59 milion m ³ në vit deri në 2017			
Qarkullimi i shitjeve për ujë dhe ujëra të zeza (duke përfshirë taksat e kycjes dhe të ardhurat tjera)	Të rritet nga 3.79 milion € në 2014 në 4.02 milion € deri në 2017 (në nivelet e çmimeve të 2014)			

Kompania Rajonale e Ujësjetillësit Bifurkacioni (Ferizaj)

Obligimet e KRU				
Efiçienca e shpenzimeve operative				
Shërbimet e furnizimit me ujë	Reduktim i shpenzimeve operative totale për tre vite të procesit tarifar 2015-2017, prej 3,479,974 € në 3,298,602€ pra një zvogëlim prej 181,372€ (në nivelet e çmimeve të 2014). Këto reduktime janë bazuar në shpenzimet reale të vitit 2014 me ndryshim të vogël gjatë viteve 2015-2017.			
Shërbimet për ujëra të zeza	Shpenzimet operative për ujëra të zeza, Rregullatori nuk i ka sfiduar dhe ato kanë vlerën prej 562,225 €, për tre vitet e procesit rregullator 2015-2017.			
Efiçienca (arkëtimi i të ardhurave) komerciale		Kons.shtëpiak	Kons.komercial	Kons.institucion
	2014 (aktuale)	60%	60%	78%
	2017 (minimum)	71%	93%	98%
Investimet kapitale 2015 – 2017 (EURO x 1000 në nivelet e çmimeve të 2014)		Resurset e KRU-së	Grante	Totali
Furnizimi me ujë	Përtëritjet infrastrukturore	400	2,200	2,600
	Rritja infrastrukturore	20	100	120
	Mirëmbajtja kapitale për jo-infrastrukturë	400	200	600
	Rritja jo-infrastrukturore	72	0	72
	Aktivitetet Biznesore	15	5	20
	Totali	907	2,505	3,412
Shërbimet për ujërat e zeza	Përtëritjet infrastrukturore	480	0	480
	Rritja infrastrukturore	75	3,339	3,414
	Mirëmbajtja kapitale për jo-infrastrukturë	26	0	26
	Rritja jo-infrastrukturore	200	0	200
	Aktivitetet Biznesore	4	0	4
	Totali	785	3,339	4,124
Konsumatorët & shitjet				
Furnizimi me ujë	Numri i konsumatorëve shtëpiak të ngriten nga 17,800 në 2014 në 22,681 deri në fund të 2017			
Ujërat e zeza	Numri i konsumatorëve shtëpiak të rritet nga 17,719 në 2014 në 19,961 deri në fund të 2017			
Shitjet për ujë	Të rritet nga 3.22 milion m ³ në vit në 2014 në 4.22 milion m ³ në vit deri në 2017			
Qarkullimi i shitjeve për ujë dhe ujëra të zeza (duke përfshirë taksat e kycjes dhe të ardhurat tjera)	Të rritet nga 1.94 milion € në 2014 në 2.45 milion € deri në 2017 (në nivelet e çmimeve të 2014)			

Kompania Rajonale e Ujësjetësit Hidromorava (Gjilan)

Obligimet e KRU				
Eficienca e shpenzimeve operative				
Shërbimet e furnizimit me ujë	Reduktim i shpenzimeve operative totale për tre vite të procesit tarifar 2015-2017, prej 3,603,816 € në 3,429,174 € pra një zvogëlim prej 174,642 € (në nivelet e çmimeve të 2014). Këto reduktime janë bazuar duke përafëruar shpenzimet operative me mesataren e sektorit si dhe duke u bazuar në shpenzimet për zërat e njëjtë të vitit 2014.			
Shërbimet për ujëra të zeza	Shpenzimet operative për ujëra të zeza, Rregullatori nuk i ka sfiduar dhe ato kanë vlerën prej 319,021 €, për tre vitet e procesit rregullator 2015-2017.			
Eficienca (arkëtimi i të ardhurave) komerciale		Kons.shtëpiak	Kons.komercial	Kons.institucion
	2014 (aktuale)	70%	93%	94%
	2017 (minimum)	76%	96%	97%
Investimet kapitale 2015 – 2017 (EURO x 1000 në nivelet e çmimeve të 2014)		Resurset e KRU-së	Grante	Totali
Furnizimi me ujë	Përtëritjet infrastrukturore	335	2,430	2,765
	Rritja infrastrukturore	30	1,620	1,650
	Mirëmbajtja kapitale për jo-infrastrukturë	0	0	0
	Rritja jo-infrastrukturore	15	735	750
	Aktivitetet Biznesore	0	0	0
	Totali	380	4,785	5,165
Shërbimet për ujërat e zeza	Përtëritjet infrastrukturore	120	80	200
	Rritja infrastrukturore	0	900	900
	Mirëmbajtja kapitale për jo-infrastrukturë	9	0	9
	Rritja jo-infrastrukturore	0	600	600
	Aktivitetet Biznesore	0	0	0
	Totali	129	1,580	1,709
Konsumatorët & shitjet				
Furnizimi me ujë	Numri i konsumatorëve shtëpiak të ngriten nga 20,944 në 2014 në 21,079 deri në fund të 2017			
Ujërat e zeza	Numri i konsumatorëve shtëpiak të rritet nga 15,434 në 2014 në 15,583 deri në fund të 2017			
Shitjet për ujë	Të rritet nga 3.44 milion m ³ në vit në 2014 në 3.95 milion m ³ në vit deri në 2017			
Qarkullimi i shitjeve për ujë dhe ujëra të zeza (duke përjashtuar taksat e kyçjes dhe të ardhurat tjera)	Të rritet nga 1.86 milion € në 2014 në 2.07 milion € deri në 2017 (në nivelet e çmimeve të 2014)			

1 QASJA E ZRRUK NË PËRCAKTIMIN E TARIFAVE

1.1 Historiku

Para vitit 2009 tarifat e furnizimit me ujë dhe tarifat për ujërat e zeza përcaktoheshin çdo vit mbi bazën e të dhënave historike financiare, e që përdoreshin si përcaktues kryesor i nevojave financiare për vitin pasues. Ky proces mori parasysh pak ose aspak objektivat e ardhshme të zhvillimit të sektorit (dhe se si do të financoheshin ato), bëri shumë pak për të nxitur efikasitetin financiar dhe operacionale dhe ka krijuar pasiguri që i ka dekurajuar investitorët.

Në vitin 2008 kemi filluar procesin tonë të parë të shqyrtimit tre vjeçarë të tarifave (2009-2011) i cili proces ishte i bazuar në projeksione largëpamëse të shpenzimeve, investimeve kapitale, dhe lejimit për kthim në kapital të mjaftueshëm për të tërhequr investitorët në sektor. Tarifat ishin vendosur paraprakisht mbi nivelet e çmimeve të vitit bazë (2008) për tre vitet e periudhës së shqyrtimit.

Ndërsa, në vitin 2011 në bashkëpunim me konsulencën e cila i dha mbështetje institucionale Rregullatorit, ne kemi përmirësuar procesin tarifor 2012-2014 duke zhvilluar një Biznes Plan Rregullator i cili ishte shumë i lehtë për t'u përdorur, kemi përmirësuar bazën e raportimit të të dhënave, si dhe jemi treguar të kujdesshëm në pritshmëritë tona për përmirësime të efikasitetit.

Ndërkaq, ky proces tarifor, 2015-2017, është vazhdimësi e procesit tarifor 2012-2014 ku janë bërë disa ndërhyrje vizuale në BPRR, përshtatja e tarifave me inflacionin si dhe normën e kthimit në kapital.

1.2 Procesi i përcaktimit të tarifave

Procesi rregullator për përcaktimin e tarifave në Kosovë është i paraqitur në Figura 1-1 në vijim. Ky proces në mënyrë të qartë përcakton rolet, përgjegjësitë dhe kufijtë e akterëve kryesorë \ në procesin e përcaktimit të tarifave:

- **Qeveria e Kosovës** – përcakton objektivat politike dhe krijon legjislacionin.
- **ZRRUK** – përdorë mjetet rregullatore (duke përfshirë legjislacionin), proceset dhe kushtet ekonomike të projektuara për të implementuar objektivat.
- **KRU** – ofrimin/dhënien e shërbimeve në përputhje me standardet e detyrueshme ligjore dhe sipas caceve / objektive të përcaktuara nga qeveria dhe/ose rregullatori dhe aktivitetet e të cilave janë të financuara nga tarifat e dakorduara.




Figura 1-1 Procesi rregullator i përcaktimit të tarifave

1.2.1 Politikat tarifore

Përbrenda kornizës së përgjithshme të procesit për përcaktimin e tarifave në muajin Mars 2014¹ ne kemi hartuar *Politikat Tarifore për Shërbimet e Furnizimit me ujë dhe Shërbime të ujërave të zeza*. Politikat kryesore që përfshihen në këtë dokument janë:

- Për secilën KRU tarifat duhet të jenë uniforme përgjatë tërë zonës së saj të shërbimit dhe për secilin grup të konsumatorëve.

¹ Ky dokument i Politikave Tarifore zëvendëson dokumentin e mëhershëm 'Politikat Tarifore për Furnizim me Ujë', të vitit 2011 me vetëm disa ndryshime minimale. Politikat tarifore mund të gjenden në: <http://www.wwro-ks.org>

- Ndër-subvencionimi ekzistues nga konsumatorët jo-shtëpiak te ata shtëpiak për shërbimet e furnizimit me ujë duhet që gradualisht me kalimin e kohës të reduktohet.
- Sa i përket shërbimeve për ujëra të zeza dallimi ekzistues në mes të tarifave të konsumatorëve jo-shtëpiak dhe atyre shtëpiak duhet të ekzistojnë pasi që konsumatorët jo-shtëpiak gjenerojnë më shumë ndotje të ujërave se konsumatorët shtëpiak².
- Tarifat duhet të jenë të mjaftueshme për të mirëmbajtur shërbyeshmërinë e aseteve dhe të financojnë investimet.
- KRU duhet t'u takojë të fitojnë kthimin në bazën rregullatore të aseteve të tyre në atë masë që të financojnë investimet kapitale në sektor.

1.2.2 Biznes planet dhe aplikacionet tarifore të kompanive

Që nga shqyrtimi i tarifave të fundit ne kemi zhvilluar një model planifikimi të biznesit gjithëpërfshirës, i cili është në përputhje të plotë me kërkesat e dala nga Politikat Tarifore dhe, posa të kompletohet nga KRU na ofron informacion të mjaftueshëm mbështetës që në mënyrë të drejtë të bëhet shqyrtimi i propozimeve të tyre tarifore. Aty ku është e nevojshme, ne jemi të gatshëm që të sfidojmë projeksionet e shpenzimeve të propozuara nga KRU, eficiencën, kërkesat për investime dhe performancën e pritshme. Figura 1-2, paraqet strukturën e modelit të biznes planit rregullator.




Figura 1-2 Modeli i biznes planit³

Edhe pse ne kemi avancuar zhvillimin e një modeli shumë të lehtë për t'u përdorur, cilësia e aplikacioneve të dorëzuara nga KRU në përgjithësi ishte e dobët. Aplikacionet kishin shumë gabime e për të cilat janë bërë përpjekje të konsiderueshme nga ZRRUK për t'i përmirësuar para se ato të jenë të pranueshme dhe të mjaftueshme për të siguruar shqyrtimin dhe sfidimin në lidhje me shpenzimet, eficiencën dhe caqet tjera. Nevoja për të korrigjuar aplikacionet ka rezultuar në vonesa të konsiderueshme përgjatë procesit rregullator për përcaktimin e tarifave.

1.2.3 Shqyrtimi i aplikacioneve të KRU nga ZRRUK

Roli ynë për të balancuar interesat e konsumatorëve me nevojën për të ruajtur integritetin financiar të KRU kërkon shqyrtim të hollësishëm të aplikacioneve tarifore të KRU. Ne e kemi për detyrë që të sigurojmë që KRU të operojnë në mënyrën më eficiente të mundshme e kjo për të siguruar që konsumatorët nuk paguajnë më shumë se që është e nevojshme. Megjithatë dihet se nivelet ideale të eficiencës nuk mund të arrihen edhe aq shpejtë dhe se ZRRUK duhet të lejojë kohë të mjaftueshme që të

² Ky është një zëvendësim për sistemet më komplekse të ngarkesave për konsumatorët jo-shtëpiak duke u bazuar në konceptin 'ndotësi pagan' i cili mund të aplikohet vetëm pasi që impiantet për trajtimin e ujërave të zeza të jenë funksionale në të gjithë rajonin e shërbimit të secilës KRU.

³ Burimi: *Rishikimi Tarifor 2015-2017 për furnizim me ujë dhe shërbime të ujërave të zeza, Procedurat.*

realizohen në mënyrë që të ketë benefite nga kjo efikasitet e përmirësuar. Për më tepër, caqet e përcaktuara duhet të jenë sfiduese, por megjithatë realiste.

Ka tre fusha kryesore në biznes planet e KRU që ne i kemi sfiduar:

1. Fuqimisht jemi të mendimit se shpenzimet operative të KRU janë shumë më të larta se sa që ato do të duhej të ishin dhe kanë ndikim direkt në tarifa. Gjatë diskutimeve tona ne i kemi shtyrë KRU që të zvogëlojnë shpenzimet e tyre operative me kalimin e kohës.
2. Ne besojmë se KRU kanë një shkallë të lartë të humbjeve komerciale (kyçjet e paligjshme dhe aktivitetet e dobëta të faturimit) të cilat mundet, nëse përmirësohen, të gjenerojnë shitje të përmirësuara për shërbimet e furnizimit me ujë dhe shërbimet e ujërave të zeza dhe në këtë mënyrë të reduktohen tarifat. Në përgjithësi ne jemi të kënaqur se në biznes planet e dorëzuara është marrë parasysh potenciali për të reduktuar humbjet e tilla.
3. Edhe pse performanca në arkëtimin e të ardhurave është duke u përmirësuar vendosmërisht jemi të mendimit se përmirësimet janë shumë të ulëta se sa ato që do duhej të ishin.

Sa i përket sifidimit të programeve investuese jemi treguar të kujdesshëm. Me të drejtë jemi të shqetësuar që KRU, duke dështuar në angazhimet e tyre në realizimin e investimeve gjatë tre viteve të fundit, mund të gjejnë arsye që të mos i përmbushin detyrimet e tilla në të ardhmen. Megjithatë ne nuk mund, thjesht t'i përjashtojmë propozimet e investimeve për arsyen e mosbesimit tonë se investimet e propozuara do të implementohen (përpos nëse ne kemi dëshmi bindëse se kjo edhe do të ndodhte), dhe çdo përjashtim i tillë duhet të bëhet vetëm në bazë të nevojave dhe prioriteteve të investimeve. Megjithatë ne kemi parasysh se programi i investimeve, e në veçanti ripërtëritja infrastrukturore, do të ketë një ndikim të drejtpërdrejtë dhe të konsiderueshëm në tarifa dhe për të ruajtur tarifat përbrenda kufijve të pranueshëm të rritjeve tarifore (pas adresimit të efikasitetit operative dhe komerciale) mund të jetë e nevojshme që të përjashtohen disa investime prioritare të ulëta, por duke pasur parasysh se kjo do të kishte një ndikim negativ në shkallën e përmirësimit të niveleve të shërbimit.

Gjatë procesit tonë për shqyrtimin e aplikacioneve tarifore i kemi kushtuar vëmendje integritetit financiar të KRU dhe në veçanti statusit të tyre financiar në sytë e investitorëve, sidomos komunitetit për zhvillim ndërkombëtar. Sektori i ujit në Kosovë (KRU, Qeveria dhe ZRRUK) duhet të tregojë se është serioz në lidhje me përmirësimin e shërbimeve dhe është i gatshëm për të marrë, ndonjëherë edhe pse mund të jenë të vështira, vendime për të arritur këtë qëllim. Është e rëndësishme të dërgojmë sinjale të qarta dhe pozitive e pa ekuivoke në treg dhe ne duhet të shmangim, me çdo kusht, që të dërgojmë sinjale negative. Tarifat e furnizimit me ujë dhe ato për shërbimet e ujërave të zeza në Kosovë janë shumë më të ulëta se niveli i mbulimit të plotë të kostos nëse përmes tyre do të synohej që të arriheshin nivelet e standardeve Evropiane edhe nëse të njëjtat do të financoheshin në tërësi përmes burimeve vetanake financiare.

1.2.4 Draft tarifat dhe konsultimi

Gjatë muajit Nëntor 2014 ne jemi konsultuar me KKK në lidhje me draft tarifat. Komentet dhe opinionet nga KKK në përgjithësi ishin se a) nëse merret për bazë gjendja socio-ekonomike në Kosovë, tarifat janë të larta, b) opinionin e tyre ishte se konsumatorët që janë pagues të rregullt të faturave janë duke i subvencionuar konsumatorët që nuk paguajnë faturat e tyre dhe nëse KRU do të kërkonin të ardhura shtesë ata duhet të jenë më pro-aktiv në këtë fushë, dhe c) ZRRUK t'u bej presion KRU për të realizuar investimet prej burimeve vetanake, d) humbjet e ujit janë të larta, KRU-të të punojnë më shumë për reduktimin e humbjeve. Ne i kemi marrë parasysh këto komente dhe jemi përgjigjur si në vijim:

- a) Ne besojmë se për procesin tarifor 2015-2017, rritja e e tarifave është shumë e lehtë dhe e nevojshme, duke pasur parasysh ngritjen e tarifave të energjisë elektrike si dhe nevojën për investime kapitale për të mbajtur nivelin aktual të shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit.
- b) Ne pajtohemi që numri i konsumatorëve që nuk paguajnë është shumë i lartë, por në biznes planet e propozuara është projektuar një përmirësim i dukshëm në performancën e arkëtimit të të ardhurave e që do të ndihmon që niveli i tarifave të jetë më i ulët se sa që do të ishte pa këto projeksione.
- c) Gjatë këtij procesi tarifor, ZRRUK i ka kushtuar shumë rëndësi çështjes së humbjeve të ujit. Për këtë, ne kemi përdorur një metodë, të cilën e konsiderojmë shkencore dhe të

arsyeshme për sektorin në Kosovë, ku kemi marrë për bazë mesatarën sektoriale të humbjeve të ujit për metër gjatësi të gypave të ujësjellësit. Kjo nënkupton se, përkundër përpjekjeve të KRU për të reduktuar humbjet e ujit, ne i kemi sfiduar përsëri që të punojnë më shumë në këptë drejtim.

- d) Konsiderojmë se kjo është një vërejtje shumë me vend nga KKK-të, gjatë gjithë kësaj periudhe prej se Rregullatori ka filluar të funksionojë, si temë kryesore ka pasur gjithmonë shkallën e realizimit të investimeve prej burimeve vetanake. Këtë përpjekje ne do vazhdojmë ta bëjmë edhe në të ardhmen, duke llogaritur në mirëkuptimin e akterëve tjerë të sektorit.

1.2.5 Tarifat e finalizuara

Biznes planet e finalizuara rregullatore publikohen në faqen e internetit të ZRRUK në kohën e duhur.

Është e rëndësishme të kihet parasysh se tarifat e përcaktuara me këtë proces janë në nivelet e çmimeve të vitit 2014 dhe do të duhen çdo vit të rregullohen për inflacion (duke përfshirë tarifat për 2015). Tani që kemi të dhëna statistikore në dispozicion e për qëllime ilustruese ne kemi paraqitur tarifat pa rregullimet e inflacionit dhe ato të rregulluara për inflacion vetëm për vitin 2015.

Që këto tarifa të hyjnë në fuqi nga data 1 Janar 2015 për shtatë KRU, me datën 31 Dhjetor 2014 zyrtarisht janë lëshuar urdhëresat tarifore.

2 AKTET DHE KONCEPTET RREGULLATORE

Në përputhje me praktikat e mira rregullatore ne kemi përpiluar disa akte/dukumente rregullatore shtesë, në bazë të cilave vlerësohen shpenzimet dhe performanca e KRU-ve, dhe krejt kjo për të siguruar që tarifat të jenë të përcaktuara në bazë të nevojave reale financiare. Tre aktet kryesore të zhvilluara nga ZRRUK për këtë shqyrtim tarifar janë:

- Udhëzimet e kontabilitetit rregullator
- Monitorimi i performancës dhe vlerësimi i niveleve të shërbimit
- Procesi krahasues (Benchmarking) duke përdorur analizat statistikore

2.1 Udhëzimet e kontabilitetit rregullator (UKRr)

Sistemet konvencionale të kontabilitetit, në veçanti ato që përdoren nga KRU si pjesë e proceseve të kontabilitetit statutor, për arsye të ndryshme nuk janë të përshtatshme për përcaktimin e tarifave në sektorin e ujit në Kosovë. Ato nuk mund:

- të identifikojnë dhe të ndajnë të ardhurat dhe shpenzimet nga aktivitetet kryesore (të rregulluara) dhe atyre jo-thelbësore (ta pa-rregulluara);
- të ndajnë të ardhurat dhe shpenzimet sipas aktiviteteve biznesore (furnizimi me ujë dhe shërbimet për ujëra të zeza) dhe as nuk i nën-ndajnë kostot në kosto qendrat e kërkuara;
- të vënë një vlerësim të duhur të bazës rregullatore të aseteve të KRU e që reflektojnë një vlerësim të arsyeshëm të aseteve për qëllime të përcaktimit të tarifave;
- të përdorin jetëgjatësinë reale të aseteve për qëllime të zhvlerësimit;
- të marrin parasysh efektet e inflacionit në zhvlerësimin e aseteve me jetëgjatësi të gjatë;
- të ofrojnë mënyra për të përcaktuar nevojat financiare për mirëmbajtje të aseteve me jetëgjatësi të padefinuar (tubacionet);
- të llogaritet në mënyrë të duhur ndikimi i mjeteve të pa-arkëtueshme.

Ne kemi zhvilluar një sërë Udhëzimesh të Kontabilitetit Rregullator të dizajnuara për të vepruar paralelisht me proceset e kontabilitetit statutor, e që ofrojnë të dhëna shtesë (dhe/ose në format tjetër) të veçanta për nevojat e rregullimit ekonomik të KRU në Kosovë. Këto udhëzime përcaktojnë rregullat dhe proceset për:

- Qendrat e profitit dhe kostos.
- Vlerësimin e aseteve bazuar në vlerën fillestare të përcaktuar në fillim të vitit 2009 të bazës rregullatore të aseteve duke mos llogaritur shtesat dhe nxjerrjet jashtë përdorimit që nga data e hapjes.
- Ripërtëritjet infrastrukturore të llogariten për infrastrukturë (rrjetet e tubacioneve dhe asetet tjera që kanë jetëgjatësi të padefinuar).
- Zhvlerësimi sipas kostot aktuale (bazuar në indeksimin e inflacionit) për asetet jo-infrastrukturore (asetet tjera si p.sh. objektet për trajtimin e ujit dhe stacionet e pompimit).
- Provizionimi për borxhet e këqija (shlyerja e tyre), e definuar si dallimi në mes të faturimit dhe arkëtimit të të ardhurave nga viti i kaluar.

Të gjitha të dhënat financiare në këtë raport janë të paraqitura në përputhje me përkufizimet e UKRr.

2.2 Tarifat dhe vlerësimi i niveleve të shërbimeve

Është e vërtetë që në Kosovë ballafaqohemi me situata ku konsumatorët nuk kanë 24 orë ujë në ditë, gjatë verës presioni i ujit nuk është në nivelin e dëshirueshëm e në anën tjetër ka ankesa të konsiderueshme të konsumatorëve për bllokimet e shpeshta të gypacioneve të kanalizimeve. Në veçanti, nivelet e shërbimit në lidhje me cilësinë e ujit, mbulueshmërisë me shërbime (ujë dhe ujëra të zeza), besueshmërisë në furnizimin me ujë, humbjet, dhe cilësia e shkarkimit të ujërave të zeza janë shumë më poshtë se niveli i shërbimeve në një vend modern Evropian. Këto mangësi, megjithatë, mund të zgjidhen vetëm përmes investimeve të dukshme e të konsiderueshme në sektor (financuar kryesisht përmes tarifave), p.sh. në zgjerimin e shërbimeve, zëvendësimin e tubacioneve kryesore dhe ndërtimin e impianteve për trajtimin e ujërave të zeza. Sistemet e informacionit të përdorura nga KRU nuk janë mjaftueshëm të sofistikuara për të lejuar analizim të detajuar të ndryshimeve në nivelet e shërbimit në lidhje me shpenzimet kapitale. Për të qenë sa më profesional, por subjektiv, gjykimi është aplikuar për të përcaktuar nevojat dhe prioritetet për investime. Në të ardhmen ne do të duhet t'i inkurajojmë KRU që të zhvillojnë plane më shkencore të menaxhimit të aseteve e që mund të tregojnë kostot e përmirësimit në nivelet e shërbimit të cilat pastaj mund të aplikohen për të përcaktuar kërkesat e ardhshme të investimit (shih në vijim Kutinë 1).

Kutia 1: Shpenzimet në përfitjen infrastrukturore dhe nivelet e shërbimit

Shuma e duhur e mjeteve financiare të nevojshme për përtëritje efektive infrastrukturore është vështirë të përcaktohet, por pas një periudhe të arsyeshme kohore dhe me të dhëna të mjaftueshme për shpenzime dhe për performancë është e mundur që të ndërlidhet shkalla e shpenzimeve me përmirësimin apo përkeqësimin e shërbyeshmërisë së infrastrukturës (shih Figura 2-1). Në rastet ku shërbyeshmëria përkeqësohet me kalimin e kohës dhe shtrihet përtej kufijve të përcaktuar është indikacion se shpenzimet për ripërtëritje infrastrukturore kanë qenë të pamjaftueshme. Në mënyrë të ngjashme, në çoftë se shërbyeshmëria përmirësohet në mënyrë dramatike deri në pikën ku ajo kalon kufijtë e konsideruar si të domosdoshëm për qëndrueshmëri ekonomike është indikacion se shpenzimet kanë qenë të shumta dhe se ato mund të reduktohen në të ardhmen. Me kalimin e kohës, ne duhet të jemi në gjendje që të përcaktojmë nivelet e duhura të shpenzimeve që do të rezultojnë në stabilitet të tarifave dhe të niveleve të shërbimit.




Figura 2-1 Ilustrimi i monitorimit të shërbyeshmërisë infrastrukturore

2.3 Krahassimi (Benchmarking)

Ka dallime serioze në shpenzimet operative të paraqitura nga KRU. Ne përdorim tre teknika statistikore për të krahasuar shpenzimet operative:

1. Koston e resurseve dhe trajtimit të ujit krahasuar me ujin e prodhuar
2. Koston e shërbimeve të distribuimit të ujit krahasuar me gjatësinë e tubacioneve
3. Koston e aktiviteteve biznesore (për ujë) krahasuar me konsumatorët e ujit

Për shpenzimet operative të aktiviteteve të furnizimit me ujë (modelet 1 dhe 2) ne përjashtojmë kostot e energjisë pasi që këto shpenzime janë unike për secilën kompani dhe rrethanat operuese të tyre. Ne kemi bërë lejime për shpenzimet operative që të bien në nivelet më eficiente të treguara gjatë periudhës tre vjeçare rishikuese. Hollësi të mëtejshme të kësaj analize janë paraqitur në ANNEX 2.

Analiza të ngjashme krahasuese janë ndërmarrë për të përcaktuar nivelet e duhura të pritjeve për performancën në arkëtimin e të ardhurave dhe humbjeve të ujit .

3 SHQYRTIMI I APLIKACIONEVE TË KRU

3.1 Përbërja e tarifës

Qasja jonë për përcaktimin e tarifave është që të sigurojë që KRU të jenë në gjendje për të financuar aktivitetet e tyre në përputhje me standardet e përcaktuara të shërbimit dhe / ose nivelet e dakorduara të shërbimit plus kthimi i 'drejtë' në kapital për paratë që ata kanë investuar.

Tarifa përcaktohet nga kërkesa për të ardhura e që i plotëson kushtet e mësipërme pjesëtuar me vëllimin e ujit të shitur (përshtatur për eficiencën në arkëtimin e të ardhurave). Kërkesa për të ardhura është e përbërë nga tri komponente kryesore:

- Shpenzimet operative
- Mirëmbajtja kapitale e përbërë nga:
 - Përtëritjet infrastrukturore (financimi i domosdoshëm për të ruajtur shërbyeshmërinë e aseteve infrastrukturore / nëntokësore), dhe
 - Zhvlerësimi sipas kostos aktuale për asetet jo-infrastrukturore (kryesisht ato mbi tokësore).
- Kthimi në Bazën Rregullatore të Aseteve.

Përbërja e përgjithshme e kërkesës për të ardhura është e paraqitur në Figura 3-1. Kërkesat individuale për secilën KRU janë të paraqitura në ANNEX 1.




Figura 3-1 Kërkesat për të ardhura sipas aktiviteteve të shërbimit (furnizimi me ujë, ujërat e zeza dhe të kombinuara)

Procedurat Tarifore të publikuara nga ZRRUK së bashku me Udhëzimet e Kontabilitetit Rregulator japin përshkrime më të hollësishme të përbërjes së kërkesës për të ardhura dhe përcaktimin e mëvonshëm të tarifave.

3.2 Shpenzimet operative

Shpenzimet operative të KRU janë të dominuara nga shpenzimet në personel dhe energji, e ku kostoja e kombinuar arrin në 76% të shpenzimeve të përgjithshme operative, shih Figura 3-2.




Figura 3-2 Ndarja e shpenzimeve operative sipas kategorive të shpenzimeve (pas rregullimeve të ZRRUK për qëllime të përfuturit në efikasitetin operative)

Ne jemi fuqimisht të mendimit se këto shpenzime operative janë joefikase me personel të shumtë në shumicën e ndoshta edhe në të gjitha KRU. Për këtë arsye ne kemi bërë rregullimet e propozimeve të shpenzimeve operative siç ilustron në Tabela 3-1 e që përmes kësaj është arritur një reduktim në shpenzimet operative vjetore prej rreth 7.8% nga nivelet e paraqitura nga KRU në biznes planet e tyre fillestare të propozuara. Hollësitë e mëtejshme për metodat e adoptuara në këtë sfidë dhe rezultatet e detajuara janë të paraqitura në ANNEX 2.

Tabela 3-1 Shpenzimet e planifikuara operative (2015 – 2017) ashtu siç janë dorëzuar dhe pas rregullimeve për efikasitetin (në nivelet e çmimeve të 2014)

	Shpenzimet operative (mesatarja vjetore - EURO x 1000 në nivelet e çmimeve të 2014)		
	Biznes planet e dorëzuara	Rregullimet e ZRRUK për përmirësim të efikasitetit	Biznes planet e aprovuara nga ZRRUK
<i>Furnizimi me ujë</i>			
Resurset dhe trajtimi i ujit	7,490	- 427	7,063
Distribucioni i ujit	6,226	- 451	5,775
Aktivitetet biznesore të furnizimit me ujë	8,586	- 736	7,849
Totali i shërbimeve të furnizimit me ujë	22,303	-1,614	20,689
<i>Shërbimet e ujërave të zeza</i>			
Grumbullimi i ujërave të zeza	1,156	-53	1,102
Trajtimi i ujërave të zeza	171	0	171
Trajtimi dhe hudhja e llumit	0	0	0
Aktivitetet biznesore të shërbimeve për ujëra të zeza	615	-215	400
Totali i shërbimeve për ujëra të zeza	1,770	-268	1,675
Totali	24,073	-1,882	22,364

Ne parashikojmë që këto dobi nga efienca operative do të bëhen përmes reduktimit të shpenzimeve në personel të KRU, edhe pse janë të mundshme edhe kursimet në fushat tjera (me kusht që nuk do të rezultonte në përkeqësim të niveleve të shërbimit).

3.3 Subvencionimet operative / subvencionimet e Qeverisë

KRU nuk marrin asnjë subvencion të drejtpërdrejtë operativ me përjashtim të Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit 'Mitrovica' e cila merr mbështetje të kufizuar financiare nga Qeveria e Kosovës. Kjo mbështetje përbënë pagesën e energjisë dhe disa shpenzime të tjera e duke pasur parasysh rrethanat e veçanta të kësaj KRU në lidhje me detyrimet e qeverisë për të siguruar furnizimin me ujë edhe për pjesën veriore të Mitrovicës.

ZRRUK e konsideron të nevojshme arkëtimin 100% të shumës së faturimit të ujit të trajtuar me shumicë nga Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Mitrovica" për furnizim të veriut të qytetit. Mos inkasimi i shumës së plotë të faturimit krijon probleme dhe vështirësi financiare në operimin e kësaj kompanie, pa e neglezhuar angazhimin e saj për ngritje të efijencës në zonen jugore të shërbimit të saj.

3.4 Efienca komerciale

Në këtë proces tarifor i kemi kushtuar kujdes të shtuar çështjes mbi përmirësimin e efijencës komerciale (shkallës së arkëtimit). Për të gjitha kompanitë kemi kërkuar që, të paktën për konsumatorët institucional, efienca e arkëtimit t'i afrohet vlerës prej 100%, ndërkaj për konsumatorët biznesor të gjitha KRU-të duhet të maksimizojnë përkushtimin e tyre duke arritur kështu vlerën prej mbi 90%. Kurse

Sa i përket efijencës së arkëtimit në kategorinë e konsumatorëve shtëpiak, ne kemi përdorur metodën shkencore të analizës së regresionit, ku të gjitha KRU janë krahasuar me njëra tjetrën duke kërkuar që KRU-të të punojnë më shumë në rritjen e efijencës komerciale për këtë kategori.

Hollësi të mëtejshme për metodat e përdorura në lidhje me këtë janë të përshkruara më në hollësi në ANNEX 3.

Tabela 3-2 Performanca e planifikuar e arkëtimit të të ardhurave ashtu siq është dorëzuar dhe pastaj rregulluar për efijencë

	Mesatarja (e pa ponderuar) e pritjeve në lidhje me performancën në arkëtimin e të ardhurave			
	2014 (parashikuar)	Biznes planet e dorëzuara 2017	Rregullimet e ZRRUK për përmirësim të efijencës	Biznes planet e aprovuara nga ZRRUK për 2017
Kons.shtëpiak	61.98%	70%	3.43%	73.43%
Kons.komercial	80.14%	93.43%	0 %	93.43%
Kons.institucional	92.86%	98.00%	0 %	98.00%

3.5 Shpenzimet kapitale

Investimet e planifikuara e të dorëzuara për periudhën 2015 - 2017 arrijnë vlerën prej 106.4 milion për shërbimet e furnizimit me ujë dhe EURO 42.6 milion për shërbimet e ujërave të zeza. Përafërsisht 82% e këtij programi të investimeve është parashikuar që të financohet nga grantet përmes agjencive zhvillimore. Pjesa tjetër e këtyre investimeve, në masë prej 9.73% do të realizohet prej burimeve vetanake të KRU-ve, kurse 7.76 % janë planifikuar të realizohen prej huave të marra nga kreditë.

Është e ditur që sektori i ujit dhe ujërave të zeza në Kosovë ka nevojë serioze për investime kapitale në mënyrë që të mos vazhdojë edhe më tej përkeqësimi i gjendjes aktual të nivelit të shërbimit. Rrjedhimisht ne jemi të kujdesshëm në qasjen tonë sa i përket sifidimit të programeve të investimeve dhe

do të preferonim që investimi të rritej se sa të zvogëlohej në mënyrë që të përshpejtohej përmirësimi i nivelit të shërbimeve. Megjithatë ne kemi parasysh se rritja e investimeve sidomos atyre për përtëritje të infrastrukturës, fusha me nevojat më të mëdha për investime, rezulton edhe me ndikim rritës të tarifave, dhe për këtë tek disa KRU i kemi bërë intervenimet e nevojshme. Gjithashtu ne jemi të ndërgjegjshëm për faktin se disa KRU kanë siguruar qasje në grante të financuara nga donatorët dhe se lejimet për investime nga burimet vetanake financiare nuk janë të njëjta për të gjitha KRU.

Pos tjerash, për këtë proces tarifar, është paraparë edhe një shumë e konsiderueshme e investimeve kapitale prej kredive, që do të ndërmerren nga KRU "Prishtina".

Shpenzimet për konsumatorë për shërbimet e furnizimit me ujë për vit (përafërsisht EURO 115) janë konsideruar të arsyeshme nëse krahasohet me nivelet ndërkombëtare⁴. Duke pasur parasysh një prapambetje afatgjate të investimeve ne presim që kjo shifër të mbetet në nivelin aktual, apo edhe të rritet, në planin afatmesëm. Sa i përket ujërave të zeza shpenzimet për kycje janë në masë të madhe më të ulëta, kryesisht për shkak të investimeve të pakta ose investimeve jo-ekzistente në trajtimin e ujërave të zeza. Në planin afatgjatë ne presim që shpenzimet për investime kapitale në sektorin e ujërave të zeza të rriten ndjeshëm, e poashtu edhe tarifat, e kjo pasi që të ndërtohen impiantet për trajtimin e ujërave të zeza.

Tabela 3-3 Shpenzimet e planifikuara kapitale (2015 – 2017) ashtu siç janë dorëzuar dhe rregulluar (në nivelet e çmimeve të 2014)

	Biznes planet e aprovuara nga ZRRUK për 2015 - 2017				Shpe. për kons. EURO
	Financuara nga KRU	Financuar nga Kredia	Financuara nga Grantet	Totali	
Ujë	3,813	3,967	31,419	39,198	116.45
Përtëritjet Infrastrukturore	1,521	0	15,856	17,377	57.44
Rritja infrastrukture	1,258	0	1,320	2,578	8.52
Mirëmbajtja kap. për jo-infrastrukturë	2,102	7,595	34,296	43,993	120.31
Rritja jo-infrastrukturore	2,862	0	451	3,313	10.95
Totali për ujë	11,556	11,562	83,341	106,459	351.88
Ujëra të zeza	1,970	0	2,130	4,100	18.36
Përtëritjet Infrastrukturore	175	0	25,159	25,334	113.43
Rritja infrastrukture	53	0	1,650	1,703	7.63
Mirëmbajtja kap. për jo-infrastrukturë	200	0	9,148	9,348	41.86
Rritja jo-infrastrukturore	541	0	1,550	2,091	9.36
Totali për ujëra të zeza	2,939	0	39,637	42,576	190.63
Totali ujë + ujëra të zeza	14,495	11,562	122,978	149,035	542.51

3.6 Baza rregullatore e aseteve dhe kthimi në kapital

3.6.1 Baza rregullatore e aseteve

Baza rregullatore e aseteve fillestare (BRA), e mbi të cilën është përcaktuar kthimi në kapital është përcaktuar në vitin 2008 për Rishikimin Tarifar 2009-2011. Që nga viti 2009 KRU janë përfshirë në disa aktivitete, edhe pse të kufizuara, të investimeve e te cilat pa zhvlerësimin sipas kostos aktuale kanë rritur fare pak vlerën e BRA nga EURO 62.0 milion në EURO 63.5 milion. Programi i planifikuar i investimeve për periudhën 2015 deri 2017 (plus provizionimet buxhetore për shpenzimet gjatë vitit 2014) do të rrisin vlerën e BRA në 84.59 milion (shih Figura 3-3).

Është e rëndësishme të kihet parasysh se pjesa më e madhe e rritjes në BRA është për shkak të programit të investimeve të Kompanisë Rajonale të Ujit 'Prishtina'. Kjo rritje në BRA do të forcojë ndjeshëm gjendjen financiare të KRU përmes rritjes së kthimit në kapital jo vetëm gjatë këtij rishikimi

⁴ Në shqyrtimin e fundit të tarifave 5 vjeçare në Angli dhe Uells shpenzimet për shërbimet e furnizimit me ujë për një ekonomi familjare për vit kanë qenë përafërsisht EURO 95. Sa i përket ujërave të zeza shpenzimet për vit ishte rreth EURO 125.

tarifor por edhe gjatë rishikimeve të ardhshme. ANNEX 1 ofron hollësitë në lidhje me kthimin në kapital (mesataren për vit) për secilën KRU.




Figura 3-3 Baza Rregullatore e Aseteve (nivelet e çmimeve të 2014)

3.6.2 Kthimi në kapital

Kthimi nga kapitali për këtë proces të rishikimit tarifor është vendosur në nivelin prej 4.0% (real), kjo shifër shënon një zbritje nëse krahasohet me Rishikimin e mëparshëm tarifor 2012-2014 e ku kthimi në kapital ishte 5.3% (real).

Arsyeja pse është reduktuar norma e kthimit në kapital është se indeksi i çmimeve të konsumit nga 7.3 sa ka qenë mesatarja për vitin 2011 krahasuar me mesataren e vitit 2010 kur është caktuar kthimi në kapital për procesin tarifor 2012-2014 ka psuar rënje të vazhdueshme për të arritur në mesataren prej 0.4 për vitin 2014 në krahasim me vitin 2013. Duke marrë parasysh këto lëvizje të inflacionit mendojmë se norma prej 4.0% është e mjaftueshme për vitet 2015-2017.

3.7 Konsumatori dhe rritja e shitjeve

3.7.1 Mbulueshmëria me shërbime

Aplikacionet e biznes planeve përfshijnë propozimet e KRU për rritje të mbulueshmërisë me shërbime si për shërbimet e furnizimit me ujë e poashtu edhe për shërbimet për ujëra të zeza (shih Figura 3-4).




Figura 3-4 Planifikimi i mbulueshmërisë me shërbime (mesatarja vjetore) (ujë dhe ujëra të zeza)

Kjo ngritje pritet që të gjenerohet nga shtimi i numrit të konsumatorëve të rinj për ujë rreth 12,500 dhe për ujëra të zeza rreth 6,500 për vit (shih Tabela 3-4). Sa i përket shërbimeve të furnizimit me ujë ne presim që kjo do të ndodhë si rezultat i legalizimit të kyçjeve ilegale e që do të rezultojnë në reduktimin e nivelit të përgjithshëm të UPF (humbjet komerciale).

Tabela 3-4 Ngritja e projektuar e numrit të konsumatorëve sipas kategorive

	Mesatarja e vitit 2014	Mesatarja e vitit 2017	Rritja nga 2014 në 2017	Rritja mesatare vjetore
Konsumatorët e furnizimit me ujë				
Shtëpiak	247,012	282,359	35,347	11,782
Komercial	28,780	30,034	1,254	418
Institucional	2,419	2,571	151	50
Totali i kons. të furnizimit me ujë	278,211	314,963	36,752	12,251
Konsumatorët e shërbimeve për ujëra të zeza				
Shtëpiak	181,569	199,640	18,071	6,024
Komercial	26,080	27,524	1,444	481
Institucional	1,990	2,135	145	48
Totali i kons. të shërbimeve për ujëra të zeza	209,639	229,299	19,660	6,553

Gjatë rishikimit tonë të planeve të biznesit të KRU ne nuk kemi sfiduar projeksionet në lidhje me planet për rritjen e numrit të konsumatorëve. Arritja e parashikimeve të rritjes së numrit të konsumatorëve është vendimtare për suksesin e biznes planeve të KRU. Pa të ardhura shtesë të gjeneruara nga kjo rritje nuk ka gjasa që KRU të jenë në gjendje për të përmbushur objektivat e tyre të investimeve. Pasi që ato kanë paraqitur propozimet e tyre për rritje ne presim që një rritje të tillë edhe të realizohet dhe se KRU duhet të bëjnë çdo përpjekje për të arritur rezultatet e pritura. Biznesit planet e KRU gjithashtu ilustrojnë se një potencial i lartë i rritjes së numrit të konsumatorëve si dhe i shitjeve do të jetë rrjedhojë e legalizimit të kyçjeve ilegale. Kjo duhet të sigurojë një mundësi për rritje të shitjeve pa rritje proporcionale të kapacitetit prodhues. Poashtu do të kontribuojë në reduktimin neto të UPF.

Mbulueshmëria me shërbime e shprehur si përqindje e konsumatorëve shtëpiak në zonën e shërbimit të KRU është e paraqitur në Figura 3-5. Në bazë të të dhënave nga e kaluara dhe normave të parashikuara të rritjes së numrit të konsumatorëve mbulueshmëria e plotë me shërbime do të arrihet përafërisht rreth vitit 2020 sa i përket furnizimit me ujë. Për shërbimet e ujërave të zeza, mbulueshmëria e plotë me shërbime do zgjasë edhe më shumë, përpos nëse përshtepohen investimet për zgjerim të shërbimit. Hollësi të mëtejshme në lidhje me rritjen e shitjeve dhe numrit të konsumatorëve janë të paraqitura në ANNEX 5.




Figura 3-5 Mbulueshmëria me shërbime 2010 – 2017

3.7.2 Projektionet e shitjeve (volumetrike dhe në vlerë monetare)

Biznes planet e KRU e ndërlidhin rritjen e numrit të konsumatorëve me projektionet për rritjen e shitjeve të ujit (shih Tabela 3-5). Shihet qartë se rritja e numrit të konsumatorëve që shërbehen me shërbime të furnizimit me ujë pritet që të jetë minimale.

Tabela 3-5 Rritja e projektuar në shitjet për ujë (m³ x 1000)

	2014	2017	Rritja 2015 deri 2017	Rritja mesatare vjetore
Konsumatorët me shërbime të ujit dhe ujërave të zeza	43,657	53,354	5,133	3,232
Konsumatorët vetëm me shërbime të ujit	19,530	24,186	3,079	1,552
Totali i ujit të faturuar	63,186	77,539	8,212	4,784

Projektionet e shitjeve, shprehur në vlerë monetare, janë rregulluar nga biznes planet e KRU për shkak të sfidave të bëra për shpenzimet operative, arkëtimin e të ardhurave dhe investimeve kapitale të paraqitura më sipër që kishin ndikim në tarifa. Duke u bazuar në tarifat e derivuara dhe projektionet për rritje të shitjeve volumetrike vlera monetare e rritjes së projektuar (në nivelet e çmimeve të vitit 2014) është e paraqitur në Figura 3-6.




Figura 3-6 Projektionet e rritjes së shitjeve paraqitur në vlerë monetare (EUROx1000 me nivelet e çmimeve 2014)

3.8 Strukturat e tarifës

3.8.1 Ngarkesat fikse dhe ato të ndryshueshme

Struktura e tanishme e tarifës për shërbimet e furnizimit me ujë përbëhet nga komponenti i tarifës fikse dhe ngarkesës volumetrike për ujin e shitur të shprehur në m³. Për ujërat e zeza ngarkesa (tarifa) është e bazuar kundrejt ngarkesës volumetrike të ujit të shitur. Disa KRU në biznes planet e tyre kanë propozuar një rritje të komponentit fiks ngarkues të strukturës tarifore (tarifës fikse). Pas marrjes në konsideratë, ne i kemi refuzuar propozimet e tilla për shkak të ruajtjes së uniformitetit në tërë Kosovën dhe tarifat fikse aktuale në vlerë prej EURO 1.00 për muaj për konsumatorët shtëpiak dhe EURO 3.00 për muaj për konsumatorët jo-shtëpiak do të mbesin të pandryshuara deri në vitin 2017. Duke i rivendosuar tarifat fikse në nivelet aktuale e në përputhje me rrethanat tarifa volumetrike është rregulluar dhe nuk ka ndonjë ndikim (përfitim e as humbje) në rrjedhat e të ardhurave të KRU si rezultat i këtij rregullimi.

3.8.2 Ndër-subvencionimi nga konsumatorët jo-shtëpiak në konsumatorët shtëpiak

Tarifat për konsumatorët jo-shtëpiak aktualisht janë 2.0-2.5 herë më të larta se tarifat për konsumatorët shtëpiak. Në përputhje me politikat tarifore të ZRRUK dhe për të promovuar efikasitet më të madhe ekonomike ne u kemi udhëzuar KRU që në biznes planet e tyre të përfshijnë një reduktim gradual të këtij ndër-subvencionimi. Tarifat për konsumatorët jo-shtëpiak do të jenë në masë të konsiderueshme më të larta se ato të konsumatorëve shtëpiak por deri në vitin 2017 ky raport do të reduktohet mesatarisht prej 1.9-2.2.

4 TARIFAT DHE NDIKIMI NË FATURAT PËR KONSUMATORËT SHTËPIAK

4.1 Tarifat për vitet 2015 - 2017

Tarifat për periudhën 2015 - 2017 janë përcaktuar nga biznes planet që janë rregulluar nga ZRRUK. Hollësitë janë të paraqitura në ANNEX 6. Për periudhën 2015 - 2017 komponenti fiks i tarifës për shërbimet e furnizimit me ujë do të ngelet i pandryshuar në nivelet aktuale, EURO 1.00 për muaj për konsumatorë shtëpiak dhe EURO 3.00 për muaj për konsumatorët komercial dhe institucional. Mesatarja e ponderuar e tarifave volumetrike për periudhën rishikuese e duke u bazuar në nivelet e çmimeve të vitit 2014 janë të prezantuara në Tabela 4-1.

Tabela 4-1 Mesatarja e ponderuar e tarifave volumetrike 2014 – 2017 (nivelet e çmimeve të 2014)

	2014 (aktuale)	2015	2016	2017
Furnizimi me ujë (për m³ të ujit të shitur)				
Shtëpiak	0.342	0.350	0.350	0.356
Komercial	0.734	0.745	0.746	0.756
Institucional	0.734	0.745	0.746	0.756
Shërbimet për ujëra të zeza (për m³ të ujit të shitur)				
Shtëpiak	0.067	0.069	0.069	0.067
Komercial	0.138	0.137	0.137	0.134
Institucional	0.138	0.137	0.137	0.134

4.2 Ndikimi në faturat e konsumatorëve shtëpiak

Ndikimi në faturat për konsumatorët shtëpiak dhe rregullimet tona të bëra në biznes planet e dorëzuara e të paraqitura si mesatarja e faturës për konsumatorë shtëpiak është i prezantuar në Tabela 4-2.

Tabela 4-2 Ndikimi në faturat e konsumatorëve shtëpiak (mesatarja përgjatë viteve 2015 – 2017 e shprehur në EURO për muaj në nivelet e çmimeve të 2014)

	Njësia	2014	2015	2016	2017	Mesatarja 2015-2017
Shpenzimi i ujit ndër vite (x1000)	m3/vit	48,329	54,215	55,959	61,126	57,100
Numri total i kons. shtëpiak	kons/vit	247,012	258,513	270,246	282,359	270,372
Shpenzimi mujor i ujit ndër vite	m3/muaj	16.30	17.48	17.26	18.04	17.59
Tarifa mesatare e ponderuar për ujë (kons.shtëpiak)	€/m3	0.3420	0.3500	0.3499	0.3559	0.3520
Tarifa mesatare e ponderuar për U.Z (kons. Shtëpiak)	€/m3	0.0667	0.0690	0.0688	0.0674	0.07
Fatura mujore për ujë	€/muaj	5.58	6.12	6.04	6.42	6.19
Fatura mujore për ujëra të zeza	€/muaj	1.09	1.21	1.19	1.22	1.20
Tarifa fikse mujore	€/muaj	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00
Fatura totale mujore për ujë dhe ujëra të zeza dhe tarifa fikse	€/muaj	7.66	8.32	8.23	8.64	8.40
Fatura totale me TVSH	€/muaj	8.89	9.66	9.54	10.02	9.74

ANNEX 1 Kërkesa për të ardhura

Shënim: Kërkesa për të ardhura përbëhet nga ato aktivitete që financohen nga KRU-të dhe nuk përfshinë aktivitetet e mirëmbajtjes kapitale të financuara nga grantet. Rrjedhimisht, vlera e ulët në mirëmbajtje kapitale nuk është tregues se do të ketë pak investime në mirëmbajtje kapitale por më tepër ka të bëjë me atë se shumica e këtyre investimeve pritet që të financohen nga grantet e dhëna nga agjencitë zhvillimore dhe/ose Qeveria.

Furnizimi me ujë

	PR	PZ	PE	MIT	GJA	FE	GJI	Total
<i>EURO x 1000 (mesatarja për vit – nivelet e çmimeve të 2014)</i>								
Shpenzimet operative	9,031	3,070	2,043	2,148	2,154	1,100	1,143	20,689
Mirëmbajtja kapitale	1,131	171	202	20	195	158	138	2,014
Kthimi në kapital	1,276	305	333	191	291	68	109	2,573
Totali	11,437	3,546	2,578	2,359	2,640	1,326	1,390	25,276
<i>Përqindja e kërkeses për të ardhurat</i>								
Shpenzimet operative	79.0%	86.6%	79.3%	91.1%	81.6%	83.0%	82.3%	81.9%
Mirëmbajtja kapitale	9.9%	4.8%	7.8%	0.8%	7.4%	11.9%	9.9%	8.0%
Kthimi në kapital	11.2%	8.6%	12.9%	8.1%	11.0%	5.1%	7.8%	10.2%

Shërbimet për ujërat e zeza

	PR	PZ	PE	MIT	GJA	FE	GJI	Total
<i>EURO x 1000 (mesatarja për vit – nivelet e çmimeve të 2014)</i>								
Shpenzimet operative	550	238	135	197	261	187	106	1,675
Mirëmbajtja kapitale	234	82	68	67	36	35	51	573
Kthimi në kapital	308	101	70	73	68	43	49	712
Total	1,093	420	273	337	365	266	206	2,961
<i>Përqindja e kërkeses për të ardhurat</i>								
Shpenzimet operative	50.4%	56.5%	49.5%	58.5%	71.5%	70.6%	51.5%	56.6%
Mirëmbajtja kapitale	21.5%	19.5%	24.8%	19.8%	10.0%	13.2%	24.6%	19.4%
Kthimi në kapital	28.2%	24.0%	25.7%	21.7%	18.6%	16.2%	23.9%	24.1%

ANNEX 2 Shpenzimet operative


Në këtë proces tarifor është përdorur analiza e mesatares së sektorit për t'i sfiduar KRU-të që të jenë më efektiv në kontekstin shpenzimeve operative. Kësaj here, për shpenzimet operative në ujëra të zeza, nuk është ndërmarrë ndonjë analizë shkencore për t'i sfiduar ato, përpos që tek KRU "Hidroregjioni-Jugor" janë bërë ndërhyrjet e nevojshme. Këto sfidime janë bërë vetëm për shërbimet e ujësjellësit.

Me anë të kësaj metode shkencore është bërë e mundur që shpenzimet operative të futen në raport me të dhëna të caktuara duke i sfiduar për tre kostoqendra, sipas kësaj renditje:

- Shpenzimet operative në resurse dhe trajtim në raport me sasinë e ujit të prodhuar në m³.
- Shpenzimet operative në distribuim në raport me gjatësinë e gypave të ujësjellësit.
- Shpenzimet operative në aktivitete biznesore në raport me numrin e konsumatorëve.

Shpenzimet operative për furnizim me ujë


Resurset dhe trajtimi i ujit



Arsyeshmëria:

1. Shpenzimet për energji dhe ujin e blerë me shumicë janë përjashtuar. Pasi që energjia (kostot për energji) janë unike për secilin mjedis operues të KRU, kurse në ujin me shumicë furnizohen vetëm KRU "Mitrovica" dhe "Prishtina".
2. Analizë e njëjtë është përdorur edhe për dy vitet tjera të procesit tarifor, 2016 dhe 2017.
3. KRU-të që gjenden nën mesataren e sektorit, për këtë kategori sfiduese, nuk u janë zvogëluar shpenzimet operative.
4. KRU-të që gjenden mbi mesataren e sektorit, ZRRUK ka kërkuar që shpenzimet operative në këtë kostoqendër t'i për afrohen mesatares së sektorit për 1/3-ën.


Distribuími i ujit



Arsyeshmëria:

1. Shpenzimet e energjisë të përjashtuara pasi energjia nuk është unike për secilin mjedis operues të KRU.
2. Analizë e njëjtë është përdorur edhe për dy vitet tjera të procesit tarifar, 2016 dhe 2017.
3. KRU-të që gjenden nën mesataren e sektorit, për këtë kategori sfiduese, nuk u janë zvogëluar shpenzimet operative.
4. KRU-të që gjenden mbi mesataren e sektorit, ZRRUK ka kërkuar që shpenzimet operative në këtë kostoqendër t'i përafrohen mesatares së sektorit për 1/3-ën.

Aktivitetet biznesore - ujë



Arsyeshmëria:

1. Në këtë kosto qendër janë përfshirë të gjitha shpenzimet operative.
2. Analizë e njëjtë është përdorur edhe për dy vitet tjera të procesit tarifar, 2016 dhe 2017.
3. KRU-të që gjenden nën mesataren e sektorit, për këtë kategori sfiduese, nuk u janë zvogëluar shpenzimet operative.
4. KRU-të që gjenden mbi mesataren e sektorit, ZRRUK ka kërkuar që shpenzimet operative në këtë kostoqendër t'i përafrohen mesatares së sektorit për 1/3-ën.

Aplikacionet për shpenzime operative dhe rregullimet e ZRRUK

Shpenzimet operative për shërbimet e furnizimit me ujë (2015 - 2017) për secilën kompani në nivelet e çmimeve të vitit 2014 (EURO x 1000 mesatarja për vit)

	PR	PZ	PE	MIT	GJA	FE	GJI	Total
<u>Biznes planet e dorëzuara të KRU</u>								
Resurset dhe trajtimi	3,407	1,634	208	1,016	378	366	482	7,490
Distribuimi	1,842	862	1,714	576	552	398	283	6,227
Aktivitetet biznesore	4,643	748	330	557	1,477	396	436	8,586
Totali	9,892	3,243	2,251	2,148	2,407	1,160	1,201	22,303
<u>Rregullimet e ZRRUK</u>								
Resurset dhe trajtimi	-261	- 115	- 0	-0	-0	- 21	- 30	-427
Distribuimi	-169	-38	-208	-0	-0	- 21	- 16	-451
Aktivitetet biznesore	-431	-21	-0	-0	- 252	- 18	- 13	-736
Totali	-861	-174	-208	-0	-252	-60	-58	-1,614
<u>Shpenzimet e përcaktuara e të lejuara nga ZRRUK</u>								
Resurset dhe trajtimi	3,146	1,520	208	1,016	378	344	452	7,064
Distribuimi	1,673	824	1,505	576	552	378	267	5,776
Aktivitetet biznesore	4,211	726	330	557	1,225	377	423	7,850
Totali	9,031	3,070	2,043	2,148	2,154	1,100	1,143	20,689


Shpenzimet operative për shërbimet e ujërave të zeza (2015 - 2017) për secilën kompani në nivelet e çmimeve të vitit 2014 (EURO x 1000 mesatarja për vit)

	PR	PZ	PE	MIT	GJA	FE	GJI	Total
<u>Biznes planet e dorëzuara të KRU</u>								
Grumbullimi	392	271	117	73	110	119	75	1,156
Trajtimi ujërave të zeza	0	0	0	100	72	0	0	172
Trajtimi i llumit/derdhja.	0	0	0	0	0	0	0	0
Aktivitetet biznesore	159	62	18	25	79	68	32	443
Totali	550	333	135	197	261	119	106	1,771
<u>Rregullimet e ZRRUK</u>								
Grumbullimi	0	-53	0	0	0	0	0	-53
Trajtimi ujërave të zeza	0	0	0	0	0	0	0	0
Trajtimi i llumit/derdhja.	0	0	0	0	0	0	0	0
Aktivitetet biznesore	0	-42	0	0	0	0	0	-42
Totali	0	-96	0	0	0	0	0	-96
<u>Shpenzimet e përcaktuara e të lejuara nga ZRRUK</u>								
Grumbullimi	392	218	117	73	110	119	75	1,103
Trajtimi ujërave të zeza	0	0	0	100	72	0	0	172
Trajtimi i llumit/derdhja.	0	0	0	0	0	0	0	0
Aktivitetet biznesore	159	20	18	25	79	68	32	400
Totali	550	238	135	197	261	187	106	1,675

ANNEX 3 Eficienca komerciale

Në mënyrë që të arrihet deri te përcakimi i "më të përshtatshmit" është bërë analiza e regresionit linear të propozimeve të efijencës komerciale (efijencia në arkëtimin e të ardhurave) e bazuar në shkallën e pritshme të përmirësimit nga nivelet aktuale (2014) në ato që priten në vitin 2017 relative me nivelet aktuale. Linja e "më të përshtatshmit" pastaj zhvendoset paralelisht me atë që ka performancën më të mirë (shih diagramin në vijim). Lejimet për efijencë komerciale pastaj përcaktohen nga kjo linjë e zhvendosur. Ky sfidim është bërë vetëm për konsumatorët shtëpiak, kurse për dy kategoritë tjera të konsumatorëve, nuk është aplikuar ndonjë metodë shkencore për përmirësimin e shkallës së arkëtimit, por që ZRRUK ka kërkuar se konsumatorët institucional t'i përafrohen arkëtimit në 100% kurse për ata biznesor të jenë mbi 90%.

Konsumatorët shtëpiak



Aplikacionet e efijencës komerciale dhe rregullimet e ZRRUK

	PR	PZ	PE	MIT	GJA	FE	GJI	Mesatare (e pa-ponderuar)
<u>Shkalla e arkëtimit sipas biznes planeve të dorëzuara nga KRU në 2014</u>								
Shtëpiak	64%	69%	60%	42%	69%	60%	70%	64%
Komercial	82%	89%	75%	85%	77%	60%	93%	82%
Institucional	92%	95%	95%	100%	96%	78%	94%	92%
<u>Shkalla e arkëtimit sipas projeksioneve të paraqitura në biznes planet e KRU për 2017</u>								
Shtëpiak	76%	74%	75%	51%	72%	66%	74%	70%
Komercial	93%	91%	90%	97%	94%	93%	96%	93%
Institucional	97%	98%	98%	100%	98%	98%	97%	97%
<u>Rregullimet e ZRRUK në shkallën e projektuar të arkëtimit për 2017</u>								
Shtëpiak	1%	2%	0%	13%	3%	5%	2%	3%
Komercial	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%
Institucional	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%
<u>Shkalla e projektuar dhe e përcaktuar nga ZRRUK për 2017</u>								
Shtëpiak	77%	76%	75%	64%	75%	71%	76%	73%
Komercial	93%	91%	90%	97%	94%	93%	96%	93%
Institucional	97%	98%	98%	100%	98%	98%	97%	97%

Shënim: Qysh në fillim të procesit tarifar 2015-2017, ZRRUK ka paralajmëruar të gjitha KRU-të se shkalla e arkëtimit për konsumatorët komercial dhe institucional duhet të jetë mbi 90% respektivisht afër 100%. Për këtë, në tabelën e mësipërme figuron që ZRRUK nuk ka bërë ndërhyrje në dy kategori të konsumatorëve.

ANNEX 4 Programi i shpenzimeve kapitale

Kompania Rajonale e Ujësjetës 'Prishtina' (Prishtinë)

	Biznes planet e aprovuara nga ZRRUK për 2015 - 2017				Shpenzimet për kons. EURO
	Të financuara nga KRU	Të financuara nga Kreditë	Financuara nga grantet	Totali	
Ujë					
Përtëritjet Infrastrukturore	1,960	3,967	7,367	13,293	120
Rritja infrastrukturore	50	0	0	50	0
Mirëmbajtja kap. për jo-infrastrukturë	508	0	0	1,508	14
Rritja jo-infrastrukturore	1,545	7,597	7,595	24,140	218
Totali për ujë	4,063	11,562	23,367	38,991	352
Ujëra të zeza	675	0	0	675	0
Përtëritjet Infrastrukturore	0	0	0	0	0
Rritja infrastrukturore	0	0	0	0	0
Mirëmbajtja kap. për jo-infrastrukturë	0	0	0	0	0
Rritja jo-infrastrukturore	0	0	0	0	0
Totali për ujëra të zeza	675	0	0	675	7.3
Totali ujë + ujëra të zeza	4,738	11,562	23,367	39,666	359

Kompania Rajonale e Ujësjetës 'Hidroregjioni Jugor' (Prizren)

	Shpenzimet kapitale për 2015-2017 (EURO x 1000 në nivelet e çmimeve të vitit 2014)			Shpenzimet për kons. EURO
	Biznes planet e aprovuara nga ZRRUK për 2015 - 2017			
	Të financuara nga KRU	Financuara nga grantet	Totali	
Ujë	338	15,972	16,310	358
Përtëritjet Infrastrukturore	311	6,975	7,286	160
Rritja infrastrukture	175	120	295	6
Mirëmbajtja kap. për jo-infrastrukturë	30	16,590	16,620	365
Rritja jo-infrastrukturore	48	100	148	3
Totali për ujë	902	39,757	40,659	892
Ujëra të zeza	240	2,050	2,290	63.9
Përtëritjet Infrastrukturore	0	6,104	6,104	170.4
Rritja infrastrukture	3	1,650	1,653	46.1
Mirëmbajtja kap. për jo-infrastrukturë	0	8,548	8,548	238.7
Rritja jo-infrastrukturore	0	1,550	1,550	43.3
Totali për ujëra të zeza	243	19,902	20,145	562
Totali ujë + ujëra të zeza	1.145	59,659	60,804	1,454

Kompania Rajonale e Ujësjiellësit 'Hidrodrini' (Pejë)

	Shpenzimet kapitale për 2015-2017 (EURO x 1000 në nivelet e çmimeve të vitit 2014)			Shpenzimet për kons. EURO
	Biznes planet e aprovuara nga ZRRUK për 2012 - 2014			
	Të financuara nga KRU	Financuara nga grantet	Totali	
Ujë	420	0	420	10.3
Përtëritjet Infrastrukturore	210	400	610	14.9
Rritja infrastrukture	175	0	175	4.3
Mirëmbajtja kap. për jo-infrastrukturë	440	16	456	11.1
Rritja jo-infrastrukturore	400	90	490	12.0
Totali për ujë	1,645	506	2,151	52.6
Ujëra të zeza	180	0	180	10.2
Përtëritjet Infrastrukturore	100	816	916	52.1
Rritja infrastrukture	15	0	15	0.9
Mirëmbajtja kap. për jo-infrastrukturë	0	0	0	0.0
Rritja jo-infrastrukturore	319	0	319	18.2
Totali për ujëra të zeza	614	816	1,430	81.4
Totali ujë + ujëra të zeza	2,259	1,322	3,581	134

Kompania Rajonale e Ujësjiellësit 'Mitrovica' (Mitrovicë)

	Shpenzimet kapitale për 2015-2017 (EURO x 1000 në nivelet e çmimeve të vitit 2014)			Shpenzimet për kons. EURO
	Biznes planet e aprovuara nga ZRRUK për 2012 - 2014			
	Të financuara nga KRU	Financuara nga grantet	Totali	
Ujë	0	1,500	1,500	55.2
Përtëritjet Infrastrukturore	0	2,111	2,111	77.6
Rritja infrastrukture	0	0	0	0.0
Mirëmbajtja kap. për jo-infrastrukturë	0	1,955	1,955	71.9
Rritja jo-infrastrukturore	0	256	256	9.4
Totali për ujë	0	5,822	5,822	214.1
Ujëra të zeza	200	0	200	9.8
Përtëritjet Infrastrukturore	0	0	0	0.0
Rritja infrastrukture	0	0	0	0.0
Mirëmbajtja kap. për jo-infrastrukturë	0	0	0	0.0
Rritja jo-infrastrukturore	0	0	0	0.0
Totali për ujëra të zeza	200	0	200	9.8
Totali ujë + ujëra të zeza	200	5,822	6,022	224

Kompania Rajonale e Ujësjetillësit 'Radoniqi' (Gjakovë)

	Shpenzimet kapitale për 2015-2017 (EURO x 1000 në nivelet e çmimeve të vitit 2014)			Shpenzimet për kons. EURO
	Biznes planet e aprovuara nga ZRRUK për 2012 - 2014			
	Të financuara nga KRU	Financuara nga grantet	Totali	
Ujë	360	1,950	2,310	75.7
Përtëritjet Infrastrukturore	900	4,650	5,550	181.9
Rritja infrastrukture	0	0	0	0.0
Mirëmbajtja kap. për jo-infrastrukturë	0	0	0	0.0
Rritja jo-infrastrukturore	194	0	194	6.3
Totali për ujë	1,454	6,600	8,054	264.0
Ujëra të zeza	75	0	75	4.2
Përtëritjet Infrastrukturore	0	14,000	14,000	784.0
Rritja infrastrukture	0	0	0	0.0
Mirëmbajtja kap. për jo-infrastrukturë	0	0	0	0.0
Rritja jo-infrastrukturore	0	0	0	0.0
Totali për ujëra të zeza	75	14,000	14,075	788.2
Totali ujë + ujëra të zeza	1,529	20,600	22,129	1,052

Kompania Rajonale e Ujësjetillësit 'Bifurkacioni' (Ferizaj)

	Shpenzimet kapitale për 2015-2017 (EURO x 1000 në nivelet e çmimeve të vitit 2014)			Shpenzimet për kons. EURO
	Biznes planet e aprovuara nga ZRRUK për 2012 - 2014			
	Të financuara nga KRU	Financuara nga grantet	Totali	
Ujë	400	2,200	2,600	109.4
Përtëritjet Infrastrukturore	20	100	120	5.1
Rritja infrastrukture	400	200	600	25.3
Mirëmbajtja kap. për jo-infrastrukturë	72	0	72	3.0
Rritja jo-infrastrukturore	15	5	20	0.8
Totali për ujë	907	2,505	3,412	143.6
Ujëra të zeza	480	0	480	21.8
Përtëritjet Infrastrukturore	75	3,339	3,414	155.1
Rritja infrastrukture	26	0	26	1.2
Mirëmbajtja kap. për jo-infrastrukturë	200	0	200	9.1
Rritja jo-infrastrukturore	4	0	4	0.2
Totali për ujëra të zeza	785	3,339	4,124	187.4
Totali ujë + ujëra të zeza	1,692	5,844	7,536	331

Kompania Rajonale e Ujësjetës 'Hidromorava' (Gjilan)

	Shpenzimet kapitale për 2015-2017 (EURO x 1000 në nivelet e çmimeve të vitit 2014)			Shpenzimet për kons. EURO
	Biznes planet e aprovuara nga ZRRUK për 2012 - 2014			
	Të financuara nga KRU	Financuara nga grantet	Totali	
Ujë	335	2,430	2,765	116.7
Përtëritjet Infrastrukturore	30	1,620	1,650	69.7
Rritja infrastrukture	0	0	0	0.0
Mirëmbajtja kap. për jo-infrastrukturë	15	735	750	31.7
Rritja jo-infrastrukturore	0	0	0	0.0
Totali për ujë	380	4,785	5,165	218.1
Ujëra të zeza	120	80	200	11.6
Përtëritjet Infrastrukturore	0	900	900	52.0
Rritja infrastrukture	9	0	9	0.5
Mirëmbajtja kap. për jo-infrastrukturë	0	600	600	34.7
Rritja jo-infrastrukturore	0	0	0	0.0
Totali për ujëra të zeza	129	1,580	1,709	98.8
Totali ujë + ujëra të zeza	509	6,365	6,874	317

ANNEX 5 Projeksionet për konsumatorë

Projeksionet për konsumatorë 2014 - 2017

	PR	PZ	PE	MIT	GJA	FE	GJI	Total
Furnizimi me ujë								
<u>Fundi i 2014</u>								
Shtëpiak	90,918	34,793	34,123	21,956	26,480	17,800	20,944	247,012
Komercial	10,732	4,628	4,021	2,020	3,276	1,687	2,417	28,780
Institucional	654	623	350	273	223	149	149	2,419
Totali 2014	102,305	40,044	38,493	24,249	29,978	19,635	23,509	278,211
<u>Fundi i 2017</u>								
Shtëpiak	103,802	42,649	37,850	27,046	27,252	22,681	21,079	282,359
Komercial	11,283	4,742	4,085	2,045	3,329	2,024	2,527	30,034
Institucional	695	699	353	273	236	181	135	2,571
Totali 2017	115,780	48,090	42,288	29,364	30,817	24,885	23,741	314,963
Rritja për vit								
Shërbimet e ujërave të zeza								
<u>Fundi i 2014</u>								
Shtëpiak	74,167	29,178	14,041	16,827	14,205	17,719	15,434	181,569
Komercial	10,345	4,571	3,294	1,963	2,628	1,687	1,593	26,080
Institucional	623	602	167	245	106	153	95	1,990
Total 2014	85,135	34,351	17,502	19,035	16,938	19,558	17,122	209,639
<u>Fundi i 2017</u>								
Shtëpiak	84,743	31,149	14,125	18,577	15,502	19,961	15,583	199,640
Komercial	10,968	4,936	3,294	1,985	2,690	2,024	1,628	27,524
Institucional	661	655	167	243	118	192	100	2,135
Totali 2017	96,372	36,740	17,586	20,805	18,310	22,176	17,310	229,299

ANNEX 6 Tarifat e 2015 - 2017

Tabelat e paraqitura në vijim paraqesin tarifën fikse të përcaktuar nga ZRRUK dhe poashtu edhe tarifën volumetrike për secilën kompani. Urdhëresat e publikuara tarifore kanë përcaktuar tabelat tarifore për taksat e kyçjes dhe shpenzimet tjera të ndërlidhura.

Tarifat fikse (EURO për konsumatorë për muaj) - për të gjitha KRU

	2015	2016	2017
Shtëpiak	1.00	1.00	1.00
Komerical	3.00	3.00	3.00
Institucional	3.00	3.00	3.00

Shënim: Këto ngarkesa (tarifa) fikse janë të përcaktuara në nivele të çmimeve nominale dhe nuk do të rregullohen për inflacion.

Tarifat volumetrike (ujë dhe ujëra të zeza)

Tabelat e paraqitura në vijim paraqesin tarifën për shitjet e ujit në m³ për furnizim me ujë dhe shërbime të ujërave të zeza si shtesë e tarifës fikse mujore. Tarifat për 2015-2017 janë të paraqitura sipas niveleve të çmimeve të vitit 2014 me katër shifra pas presjes dhjetore dhe duhet t'i nënshtrohen (të jenë subjekt) i rregullimeve të inflacionit vjetor në përputhje me treguesin e inflacionit të muajit Tetor të vitit paraprak. Tabelat poashtu për vitin 2015 ofrojnë tarifën finale në të cilat është i llogaritur inflacioni.

Kompania Rajonale e Ujësjetllësit 'Prishtina' (Prishtinë)

	Tarifa për m ³ të ujit të shitur (EURO)			
	Urdhëresa Tarifore për 2015 e rregulluar për inflacion	Sipas niveleve të çmimeve të vitit 2014		
		2015	2016	2017
Furnizimi me ujë				
Shtëpiak	0.39	0.3850	0.3826	0.3784
Komerical	0.88	0.8623	0.8533	0.8400
Institucional	0.88	0.8623	0.8533	0.8400
Ujërat e zeza				
Shtëpiak	0.05	0.0459	0.0457	0.0461
Komerical	0.11	0.1050	0.1046	0.1013
Institucional	0.11	0.1050	0.1046	0.1013

Kompania Rajonale e Ujësjetllësit 'Hidroregjioni Jugor' (Prizren)

	Tarifa për m ³ të ujit të shitur (EURO)			
	Urdhëresa Tarifore për 2015 e rregulluar për inflacion	Sipas niveleve të çmimeve të vitit 2014		
		2015	2016	2017
Furnizimi me ujë				
Shtëpiak	0.36	0.3514	0.3454	0.3395
Komerical	0.69	0.6781	0.6667	0.6553
Institucional	0.69	0.6781	0.6667	0.6553
Ujërat e zeza				
Shtëpiak	0.06	0.0569	0.0573	0.0575
Komerical	0.11	0.1081	0.1088	0.1093
Institucional	0.11	0.1081	0.1088	0.1093

Kompania Rajonale e Ujësjetësit 'Hidrodrini' (Pejë)

	Tarifa për m ³ të ujit të shitur (EURO)			
	Urdhëresa Tarifore për 2015 e rregulluar për inflacion	Sipas niveleve të çmimeve të vitit 2014		
		2015	2016	2017
Furnizmi me ujë				
Shtëpiak	0.24	0.2378	0.2330	0.2285
Komercial	0.48	0.4755	0.4660	0.4569
Institucional	0.48	0.4755	0.4660	0.4569
Ujërat e zeza				
Shtëpiak	0.06	0.0619	0.0612	0.0607
Komercial	0.13	0.1238	0.1224	0.1214
Institucional	0.13	0.1238	0.1224	0.1214

Kompania Rajonale e Ujësjetësit 'Mitrovica' (Mitrovicë)

	Tarifa për m ³ të ujit të shitur (EURO)			
	Urdhëresa Tarifore për 2015 e rregulluar për inflacion	Sipas niveleve të çmimeve të vitit 2014		
		2015	2016	2017
Furnizmi me ujë				
Shtëpiak	0.36	0.3500	0.3470	0.3440
Komercial	0.73	0.7175	0.7114	0.6991
Institucional	0.73	0.7175	0.7114	0.6991
Ujërat e zeza				
Shtëpiak	0.09	0.0900	0.0887	0.0874
Komercial	0.09	0.2250	0.2218	0.2186
Institucional	0.23	0.2250	0.2218	0.2186

Kompania Rajonale e Ujësjetësit 'Radoniqi' (Gjakova)

	Tarifa për m ³ të ujit të shitur (EURO)			
	Urdhëresa Tarifore për 2015 e rregulluar për inflacion	Sipas niveleve të çmimeve të vitit 2014		
		2015	2016	2017
Furnizmi me ujë				
Shtëpiak	0.36	0.3513	0.3455	0.3398
Komercial	0.71	0.7025	0.6910	0.6797
Institucional	0.71	0.7025	0.6910	0.6797
Ujërat e zeza				
Shtëpiak	0.09	0.0883	0.0869	0.0855
Komercial	0.22	0.2207	0.2173	0.2139
Institucional	0.22	0.2207	0.2173	0.2139

Kompania Rajonale e Ujësjetës 'Bifurkacioni' (Ferizaj)

Tarifa për m ³ të ujit të shitur (EURO)				
Urdhëresa Tarifore për 2015 e rregulluar për inflacion	Sipas niveleve të çmimeve të vitit 2014			
	2015	2016	2017	
Furnizimi me ujë				
Shtëpiak	0.34	0.3380	0.3337	0.3295
Komerical	0.69	0.6760	0.6674	0.6589
Institucional	0.69	0.6760	0.6674	0.6589
Ujërat e zeza				
Shtëpiak	0.12	0.1200	0.1174	0.1149
Komerical	0.29	0.2880	0.2818	0.2758
Institucional	0.29	0.2880	0.2818	0.2758

Kompania Rajonale e Ujësjetës 'Hidromorava' (Gjilan)

Tarifa për m ³ të ujit të shitur (EURO)				
Urdhëresa Tarifore për 2015 e rregulluar për inflacion	Sipas niveleve të çmimeve të vitit 2014			
	2015	2016	2017	
Furnizimi me ujë				
Shtëpiak	0.33	0.3300	0.3242	0.3186
Komerical	0.65	0.6435	0.6290	0.6180
Institucional	0.65	0.6435	0.6290	0.6180
Ujërat e zeza				
Shtëpiak	0.08	0.0745	0.0737	0.0725
Komerical	0.20	0.1938	0.1915	0.1886
Institucional	0.20	0.1938	0.1915	0.1886

Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim
Rr.Ferat Dragaj nr.68
Prishtinë, 10000
Kosovë
Tel: + 381 38249165, ext. 101/120
Fax: +381 38249168 129
<http://www.wwro-ks.org>